

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

30.12.2024

Ora 12:16

RENDI I DITËS

Projektvendim “Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Znj.M. Çelmeta, znj.J. Josifi, znj.P. Doçaj**
- **Parti Politike: PD (F. Nuri), PS (E. Xhina)**
- **OJQ: KRIIK**

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretarja e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile dhe media. Në mbledhjen e ditës së sotme, siç është njoftuar kemi një çështje në rendin e ditës, është një projektvendim të cilin e kemi pasur në

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

rendin e ditës në datën 7 dhjetor, por me vendim unanim të Komisionit Rregullator u shty për shqyrtim për një mbledhje tjetër, është projektvendimi “Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë”. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e aktit do të pyesja kolegët, anëtarë të Rregullatorit nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar? Ka z. Çakaj! Doni ta diskutoni paraprakisht?

Z. M. Çakaj: Po paraprakisht.

Znj. I. Nano: Jo në fund të shqyrtimit. Tjetër, përveç z. Çakaj, është dikush pyetje jashtë rendit të ditës? Fillojmë me z. Çakaj.

Z. M. Çakaj: Po faleminderit zonja Kryetare! Atëherë paraprakisht, siç jeni në dijeni ju të nderuar kolegë, pasi jemi informuar për zhvillimin e kësaj mbledhje, shqyrtimin e këtij projektakti, unë personalisht kam drejtuar një kërkesë me email Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që të ishte prezent në mbledhjen e sotme, nisur dhe nga rëndësia thelbësore e këtij projektakti. Do të doja një përgjigje nga administrata, se përgjigje nga Komisioneri nuk kam, përgjigje nga Sekretarja e Përgjithshme, sepse nuk ndodh?

Znj. M. Çelmeta: Nuk kemi as ne, asnjë përgjigje.

Z. M. Çakaj: Qartë, pa përgjigje! Pra Komisioneri në një akt kaq të rëndësishëm nuk merr pjesë vetë, që e ka detyrim nga Kodi Zgjedhor ta propozojë vetë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. M. Çelmeta: Nuk kemi përgjigje.

Znj. I. Nano: Faleminderit!

Z. M. Çakaj: Së pari kjo. Së dyti, unë e kam ndjekur me vëmendje procesin e prezantimit të platformës PER, e kam ndjekur online, nuk isha prezent dhe personalisht ka qenë një kërkesë prej dy-tre muajsh, e imja dhe e koleges Vukaj, lidhur me paraqitjen grafike të procesit të regjistrimit të zgjedhësve nga jashtë. Një nga parimet që ne kemi vendosur që të gjithë, është parimi i thjeshtësisë, mënyra sesi u prezantua... Së dyti mungesa e një tutoriali apo një paraqitje grafike, në vlerësimin tim e bën jashtëzakonisht, vetëm i thjeshtë nuk është, e bën shumë të komplikuar procesin. Ndërkohë që ne të gjithë së bashku kemi rënë dakord, që procesi të jetë sa më i thjeshtë, sa më i kuptueshëm dhe sigurisht i ilustruar. Pra, të jetë i kuptueshëm, i pranuar dhe lehtësisht i aplikueshëm nga të gjithë zgjedhësit nga jashtë, kjo do të çonte dhe në masivitetin e pjesëmarrësve të votuesve nga jashtë Shqipërisë, së pari. Së dyti, një problem i cili u evidentua në prezantimin e platformës PER ishte dhe mënyra sesi do të operojë kërkesa për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë. Fillimisht nga Komisioneri u pranua, ose u citua fakti se operatori i cili do të shqyrtojë dhe do të trajtojë kërkesat e zgjedhësve nga jashtë mund të punojë online. Në vlerësimin tim kjo është totalisht e papranueshme dhe këtu do të doja të kisha një informacion nga administrata e KQZ-së nëse kemi sot, kemi një sallë të posaçme, kemi kritere për operatorët, cilat janë standardet mbi të cilat operatorët do të trajtojnë kërkesat për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë? Mos harroni faktin së bashku me shoqërinë civile kur miratuar aktin kemi vendosur që çdo zgjedhës shqiptar që jeton dhe banon jashtë Shqipërisë mund të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

regjistrohet dhe do të paraqesi për të provuar adresën e tij, do të paraqesë në dokument i cili mund të jetë në gjuhën e lëshuar në shtetin e origjinës, pra çfarë cilësie do të ketë operatori? Cilat janë kriteret, që do të zgjidhet, që do të trajtojë këtë kërkesë, që do të ketë kompetencën profesionale, kompetencën personale? Sepse mund të ndodhemi përballë një situatë të tillë kur një operator, në gjykimin ka vendimmarrjen për të pranuar ose jo kërkesën për regjistrim, kështu që do të doja një sqarim shterues, mundësisht. Në fakt do e doja nga Komisioneri, por në mungesë të tij, të prezencës së tij në këtë mbledhje, po e pres nga administrata.

Znj. I. Nano: Po, zonja Josifi për këtë çështje.

Znj. J. Josifi: Ju faleminderit për pyetjen! Çështja e kriterëve edhe e përzgjedhjes së operatorëve që do të shqyrtojnë kërkesat për regjistrim, fjala operator ishte një term teknik i përdorur, ata do të jenë specialistë, e thënë kështu, për shkak të diskutimeve që patëm, kryesisht kërkesës që pati njëri prej subjekteve zgjedhore në takimin e ditës së premte, të datës 27 dhjetor, në datën 28, ditën e shtunë...

Z. M. Çakaj: Se ka marrë akoma cilësinë e subjektit zgjedhor është palë e interesuar.

Znj. J. Josifi: Ndjesë, parti politike. Ne kemi ndarë me ta, në fakt me të gjitha partitë politike që kanë përfaqësues të përhershëm në KQZ draftin tonë, ose se si e kishim menduar ne kushtet që do të duhet të plotësojnë stafi që është ngarkuar me shqyrtimin e kërkesave, jua kemi çuar për konsultim që ata të japin komente, sugjerime sa më parë që të mundën. Në propozimin tonë specialistët për shqyrtimin e kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit, si kushte të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

përgjithshme që do të duhet të plotësojnë, janë: të jenë shtetas shqiptarë, të jenë të padënuar, të kenë përfunduar studimet universitare, të paktën të masterit profesional, të nivelit master profesional, të mos kenë qenë apo të jenë anëtarë i ndonjë partie politike, të paktën në tre vitet e fundit; kushtet e veçanta, ne kemi menduar se do të preferohet fusha e studimit, nivelin e arsimit e thamë, por fusha e studimit shkencë kompjuterike, shkencë juridike, shkencë ekonomike ose shkencë sociale. Dokumentacioni që këta aplikantë do të duhet të dorëzojnë për të aplikuar në këtë pozicion pune janë dëshmia e penalitetit, kopje e noterizuar e diplomës, kopje të dokumentit të identifikimit dhe deklarim se nuk është një anëtar i ndonjë partie politike për tre vitet e fundit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën numër 3 që i bashkëlidhet udhëzimit nr. 3, të datë 3 nëntor 2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, raport të aftësisë për punë dhe librezën e punës. Ne i kemi parashtruar këto mendime, partive politike dhe u kemi lënë atyre një afat, për të dhënë mendimet e tyre, nëse mendojnë që ata do të duhet të kenë karakteristika të tjera. Ambienti, po, është një sallë në KQZ, në katin e parë, po merren masa për të siguruar pajisjet, laptopët dhe kompjuterat besoj.

Z. M. Çakaj: Qartë. Atëhere...

Znj. J. Josifi: Ndërkohë, vetëm diçka, ndjesë se harrova, në fakt me një kërkesë tuajën, të bërë në analizën vjetore, se si rregullohet çështja e aksesit në informacion që ky personel do të ketë dhe kjo vlen dhe për stafin e KQZ-së, pra stafin e përhershëm po edhe atë të përkohëshëm. Ne ndërkohë kemi konsultuar me Komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtës së informimit, faktin që të gjithë këta persona do të duhet të nënshkruajnë deklaratë konfidencialiteti, për të dhënat personale për të cilat kanë akses gjatë shqyrtimit të kërkesave. Ne

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

kemi ndarë draftin tonë me Komisionerin e të dhënave personale, kemi marrë disa komente që jemi duke i reflektuar dhe po ashtu i kemi ndarë edhe me përfaqësues të diasporës, edhe me organizata, na kanë ardhur disa komente prej tyre, dje, në darkë, po flas për deklaratën e konfidencialitetit, i cila do të jetë një dokument shtesë angazhimi për këtë kategori të stafit, krahas kontratës së punës me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, gjë që ndodh dhe për personel tjetër të përkohshëm, në KQZ si për të gjithë.

Z. M. Çakaj: Po, qartë. Të ndalemi pak te kriteret, i dëgjova me vëmendje kriteret të cilat ju po konsultoni me partitë politike dhe palë të interesuara. Mos ndoshta do të ishte e udhës që një nga kriteret të jetë dhe kriteri i gjuhës së huaj? Do të thotë, besoj unë, çdo akt, çdo dokument i cili provon rezidencën e shtetasit shqiptar me banim dhe jetesë të përhershme në vendin e huaj. Pra, ky do të ishte një kriter i cili do të ndihmonte specialistët, operatorët, do të ndihmonte Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në trajtimin me objektivitet të kërkesave, pra të kemi minimalisht specialistë të cilët zotërojnë dhjetë dhe nëse ka mundësi dhe më shumë gjuhë të huaja, pra jo, dhjetë specialistë të cilët zotërojnë secili nga një gjuhë të huaj, duke filluar nga shtetet ku ka më shumë shqiptarë, Itali, Greqi, Gjermani, Amerikë, vendet nordike...

Znj. I. Nano: Po janë me master, në kuptim të ligjit sipas arsimit të lartë e kanë të mbrojtur, një nga gjuhët.

Z. M. Çakaj: Po s'ka të mbrojtur greqishten.

Znj. I. Nano: Tani dhjetë jo po...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Z. M. Çakaj: Jo nuk po them se cila, po them të paktën të kemi dhjetë. Pra, në numrin e operatorëve, në numrin e përgjithshëm të operatorëve, të kemi të paktën kriterin e gjuhës së huaj, të kenë në tërësinë e tyre, të paktën dhjetë gjuhë të huaja, se s'mund t'i mbrojmë të gjithë gjuhët e huaja, po të paktën të jetë kjo, në mënyrë që të trajtojmë me objektivitet kërkesat, pra të shihet edhe kjo si kërkesë e mundshme. Faleminderit!

Znj. J. Josifi: E marrim këtë koment si sugjerim, do presim dhe komentet e partive dhe i integrojmë dhe dërgojmë, ndajmë pastaj me të gjithë draftin final, të thirrjes që do të hapet për këtë pozicion.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Josifi! Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në kuadër të pyetjeve që bëri kolegu Çakaj dhe ku nuk morëm përgjigje as për mungesën e prezencës sot, të Komisionerit por as edhe për arsyen pse nuk keni paraqitur gjatë kërkesave tona, një demo grafike sa herë jua kërkuam, po vijojmë me aty ku e latë përgjigjen tuaj ose pyetjen e kolegut. Në lidhje me operatorët sa do ishte numri që parashikoni?

Znj. J. Josifi: 20 si fillim, por kemi hapësirën ta shtojmë këtë numër në varësi të fluksit që do të shohim të kërkesave që do të vinë gjatë kohës sepse mundet që të rialokohet një numër i caktuar stafi i parashikuar për një proces tjetër, në këtë proces nëse shihet që ka volum të madh.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Pra mendoni që do të ketë volum të madh dhe do të duhen operatorë ekstra?

Znj. J. Josifi: Jo, nuk e dimë, por ne kemi parashikuar minimumi njëzet. Po themi vetëm nëse do të duhet që ky numër të shtohet kemi hapësirën që ta shtojmë.

Znj. H. Vukaj: A jeni në gjendje që t'i trajtoni shtesat në kohë dhe të merrni garancinë që këto shtesa operatorësh janë trajnuar po aq sa dhe të parët? Pyetja tjetër, mbas trajnimit marrin ndonjë lloj certifikimi që vërtet kanë garancinë që janë trajnuar, kanë nxënë dhe dinë ta elaborojnë procesin shumë delikat të asaj fazës në PER, ku një shtetas do të regjistrohet dhe më pas do të kualifikohet si votues, do të certifikohen këta? Pra i keni arritur ju kapacitetet me këtë proces rishtar, ju këtu brenda? Që të trajtoni po aq mirë stafin që do të importohet, këta operatorë, jeni të sigurtë që i keni lexuar dhe i keni kuptuar mirë të gjitha aktet?

Znj. J. Josifi: Po do të duhet ta bëjmë patjetër. E kemi angazhimin ta bëjmë këtë, do t'i trajnojmë edhe operatorët e fillimit dhe të tjerë nëse do të duhet, ne do të jemi, pra ai është një proces në vijueshmëri që zgjat për shumë ditë, edhe po ashtu dinamik, kështu që ne do të jemi këtu të trajnojmë këdo do të duhet ose nëse konstatojmë që operatorë të trajnuar, nuk janë duke performuar, patjetër që do të ecim në mënyrë dinamike.

Znj. H. Vukaj: Pra ju keni testuar deri tani sa stafi është i përgatitur me brumin e këtyre akteve që ne kemi miratuar, në funksion të vënies në efikasitet të këtij procesi?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. J. Josifi: Stafi i Drejtorisë së Votimit nga Jashtë ka draftuar akte të cilat më pas janë miratuar, kuptohet me ndryshime nga ana juaj, kështu që ata bëjnë këtë punë tashmë.

Znj. H. Vukaj: Pra ka një testim nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore apo drejtorisë përkatëse për trajnimin që ka njohje të këtyre akteve sepse atë ditë të demonstrimit të PER-it dhe dukej që aktet ose po anashkaloheshin ose nuk ishin kuptuar mirë?

Znj. J. Josifi: Jo nuk kemi bërë një testim, në kuptimin formal të fjalës por mund ta organizojmë atë, patjetër.

Znj. H. Vukaj: Dakord. Dhe tjetra operatorët që ju rekrutoni, padiskutim do të konsiderohen si pjesë e administratës së KQZ-së besoj, në të gjitha kuptimet e saj?

Znj. J. Josifi: Po, njësoj si të gjithë personeli i përkohshëm që KQZ-ja kontraktonte për procesin zgjedhor dhe atë brenda vendit, pra nuk kanë asnjë ndryshim, kanë një kohë pune me orar...

Z. M. Çakaj: Më fal, këta...

Znj. J. Josifi:...të plotë por të përkohshëm.

Z. M. Çakaj: Ndjesë, këta mund t'i quajmë, këta mund t'i quajmë zyrtarë zgjedhorë, operatorë?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. J. Josifi: Administratë e KQZ-së.

Z. M. Çakaj: Administratë e KQZ-së, pjesë e administratës, zyrtarë zgjedhorë, se po administrojnë të dhënat.

Znj. H. Vukaj: Administratë e KQZ-së se ndryshe ata do të ishin punonjës të shërbimit civil!

Z. M. Çakaj: Një sekond.

Znj. H. Vukaj: Ata nuk janë punonjës të shërbimit civil.

Z. M. Çakaj: Një sekond, në momentin që operatori, specialisti i rekrutuar nga KQZ-ja me qëllim të trajtojë kërkesat e zgjedhësve për t'u regjistruar, si konsiderohet, në platformën PER, në mënyrë që të votojë, si konsiderohet, a konsiderohet zyrtar zgjedhor?

Znj. J. Josifi: Konsiderohet administratë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Z. M. Çakaj: Zyrtar zgjedhor.

Znj. J. Josifi: Administratë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Z. M. Çakaj: Zyrtar zgjedhor, jemi të gjithë ne, kemi nivele të ndryshme administrimi, nivele qendror, nivel i dytë, niveli i tretë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Zyrtar i nivelit të ulët mund ta quash.

Z. M. Çakaj: Po niveli i ulët, se si mund ta konsiderosh?

Znj. I. Nano: S'është koncept i ligjit ky, zyrtar zgjedhor. Megjithatë janë administratë e KQZ-së.

Z. M. Çakaj: Jo një sekond, se kjo është thelbësore.

Znj. I. Nano: Vendimi i Kuvendit çfarë ka kur miraton këto shtesat për vitet zgjedhore, mund të na i gjeni një minutë?

Znj. J. Josifi: Ka numrin e stafit që i alokohet KQZ së për procese të ndryshme, ka arsimin, nivelin e kërkuar të arsimit...

Znj. H. Vukaj: Ka kritere?

Znj. J. Josifi: Ka kategorinë e pagës, ka detyrat, një përshkrim të detyrave që duhet të kryejë secili prej stafit të kërkuar, titullin e punësimit dhe kohëzgjatjen e punësimit...

Z. M. Çakaj: Një sekond, ta formulojmë ndryshe pyetjen, atëherë zyrtarët, më fal personeli i rekrutuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si operator PEI, PEVN, quhet zyrtar zgjedhor?

Znj. J. Josifi: Janë tjetër kategori.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Z. M. Çakaj: Pse janë tjetër kategori?

Znj. J. Josifi: Sepse operatorët e PEI-t dhe të PEVN-së merren me kontratë shërbimi, vetëm për atë ditë pune, ndërkohë stafi i përkohshëm...

Z. M. Çakaj: A trajnohen këta?

Znj. J. Josifi: Po, një moment, janë dy marrëdhënie të ndryshme...

Z. M. Çakaj: Po s'ka rëndësi marrëdhënia juridike e punës së tyre, kontratë shërbimi, nuk po pyesim për tatimin, po pyesim...

Znj. H. Vukaj: Nuk ka rëndësi kohëzgjatja.

Z. M. Çakaj: Marrëdhënia juridike e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me personelin e rekrutuar për krijuar proceset, më fal se është shumë e rëndësishme...

Znj. I. Nano: Kolegë! Jo dhe unë të rëndësishme e kam këtë që do të them, thjesht për të qartësuar në përgjigjen e pyetjes. Kishim çështje jashtë të rendit të ditës...

Z. M. Çakaj: Po jashtë rendit të ditës.

Znj. I. Nano: ...që lidhet me PER-in thatë, në raport me PER-in, tani pse shkojmë tek zyrtarë të tjerë që thoni ju?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Z. M. Çakaj: Po me PER-in ka dhe kjo lidhet. Atëherë ky është proces shumë i rëndësishëm, ky është procesi fillestar. Si konsiderohet...

Znj. H. Vukaj: Kjo na bën që të kuptojmë statusin e tyre dhe peshën që do të kenë këta në këtë institucion por njëkohësisht dhe përmbajtjen e tyre?

Z.M. Çakaj: Nuk ka rëndësi forma juridike se si, me çfarë marrëdhënie juridike...

Znj. I. Nano:Nëse na dëgjon dhe po na ndjek Drejtoria e Burimeve Njerëzore, le të na sjellin vendimet e Kuvendit.

Z. M. Çakaj: Nuk ka rëndësi forma juridike, se si lidhet marrëveshja midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe specialistëve, stafit të rekrutuar, pra personelit të rekrutuar. Nëse lidhet me kontratë shërbimi, nëse lidhet me kontratë me kohë pjesshme apo nëse kalon në filtrat e nëpunësit civil, ajo çfarë ka rëndësi sepse ai do të administrojë të dhëna, ai do administrojë procese zgjedhore, ajo çfarë ka rëndësi në rastin konkret, që në gjykimin dhe vlerësimin tim, po do të doja ta dëgjoja vlerësimin dhe bindjen e administratës së KQZ-së, si do të konsiderohet ky specialist, operatori, i cili do të administrojë të dhënat e zgjedhësve nga jashtë, do të konsiderohet administratë e KQZ-së, patjetër, zyrtar zgjedhor apo jo?

Znj. J. Josifi: Atëherë na lejoni të marrim një mendim, me ekspertizë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, edhe ndërkohë që ne jemi në mbledhje, t'i njoftojmë ata dhe të na e bëjnë këtë interpretim. Në kuptimin tim ka...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Sa të vijë informacioni nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të cilat s' do na thotë gjë tjetër veçse aq sa ka rekrutuar ajo dhe llojin e kontratës që lidhet për ta, që në fund të fundit është nën kompetencën, juridiksionin e titullarit, pra mund të lirohen nga detyra, mund të shkarkohen, ashtu siç emërohen apo jo? Këtë mund ta përcaktojë Drejtoria e Burimeve Njerëzore, këtë e kishim në konturet e konceptit të standardit dhe të ligjit në të njëjtën kohë për faza të ndryshme që do të ketë ky proces. Nga ana tjetër për sqarim meqënëse e cekëm, ata operatorët e PEVN-së dhe PEI-t, respektivisht, pavarësisht se janë për një ditë, ata votojnë si administratë zgjedhore, pra janë administratë e KQZ-së, pra janë njësoj, me të njëjtin status si dhe të operatorëve të PER-it.


Znj. J. Josifi: Në rastin e punonjësve të përkohshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, prandaj ju kërkova pak kohë që ta marrim këtë informacion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Znj. H. Vukaj: Po nuk është Drejtoria e Burimeve Njerëzore që na e sqaron, është tashmë e sqaruar ajo, është e dukshme.

Znj. J. Josifi: KQZ-ja ndërkohë paguan. Atëherë cila është pyetja? Operatorët do të jenë pjesë e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të lidhin me të një kontratë pune për një periudhë të caktuar, do të derdhen sigurimet dhe gjithë kontributet e parashikuara nga ligji njësoj si për administratën e përhershme të KQZ-së, gjë që në këtë rast nuk ndodh për operatorët.

Znj. H. Vukaj: Jo e kemi të qartë këtë standardin e vendosur.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Z. M. Çakaj: Atëherë pyetja ime ishte shumë e thjeshtë...

Znj. J. Josifi: Pra marrëdhënie e KQZ-së...

Z. M. Çakaj:...a konsiderohet, jo një sekond...

Znj. J. Josifi: ...me personelin e përkohshëm është shumë më e qëndrueshme nga pikëpamja juridike, edhe financiare.

Z. M. Çakaj: Shumë e qëndrueshme. Unë e kisha shumë të thjeshtë pyetjen, si do të konsiderohet? Se ai administron informacion, specialisti, operatori, administron informacion zgjedhor, informacion të votuesit nga jashtë dhe në vlerësimin tim ky konsiderohet zyrtar zgjedhor, do të doja të informohesha çfarë perspektive ka administrata e KQZ-së, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në lidhje me rolin dhe detyrën e tij, a konsiderohet kështu? Në gjykimin tim po. Po do të doja ta dëgjoja nga ana juaj, nëse ky nuk konsiderohet zyrtar zgjedhor, atëherë pse duhet që ky të administrojë informacion zgjedhor, mund të na japë dhe Drejtoresha Juridike një opinion ligjor.

Znj. P. Doçaj: Për sa i përket pyetjes që në fakt, e dhatë përgjigjen, ashtu siç e konsideroni ju. Ne e konsiderojmë administratë zgjedhore, për sa kohë ka një kontratë me kohë të caktuar, për sa kohë caktohen të drejta dhe detyrime që lindin nga kjo kontratë, për sa kohë ka të përshkruar atë detyrë që ai do të bëjë, për atë periudhë zgjedhore, edhe ju, edhe ne, edhe gjithë stafi i KQZ-së administron të dhëna zgjedhore, siç administrojnë të dhëna zgjedhore dhe gazetarët që futen në

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

portalin tonë, që kanë të dhëna zgjedhore, që janë numëruar kaq, janë numëruar aq...

Z. M. Çakaj: Jo të mos i ngatërrojmë.

Znj. P. Doçaj: ...pra vërtet jemi administratë e KQZ-së, pastaj sesi duhet ta ndajmë termin zgjedhor apo jo zgjedhor ndoshta...

Znj. H. Vukaj: Ju sapo e pohuat që është administratë zgjedhore.

Z. M. Çakaj: Administratë zgjedhore.

Znj. P. Doçaj: ...administratë e KQZ së, është administratë e KQZ-së

Znj. H. Vukaj: Ju e pohuat që është administratë zgjedhore.

Znj. I. Nano: Kolegë!

Znj. P. Doçaj: Jam administratë e KQZ-së, kam një kontratë me afat të caktuar, ndryshon nga kontrata që ka një operator ...

Znj. H. Vukaj: Ju jeni punonjës i shërbimit civil.

Znj. I. Nano: Tani jemi, proceduralisht të lutem, ka dhe punonjës që s'janë shërbim civil në KQZ, s'është e thënë...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Ata kanë të gjithë të drejtën që si administratë përtej shërbimit, pra administratë zgjedhore, u është dhënë e drejta dhe tagri që edhe të shtypin një buton dhe të mos konsiderojnë fare zgjedhës apo votues.

Znj. P. Doçaj: Po duke përcaktuar, po duke u përcaktuar sipas kriterëve të vendosura paraprakisht...

Znj. H. Vukaj: Kaq rëndësi ka, kaq rëndësi kanë! Ashtu sikundër dhe punonjësit tjerë të administratës zgjedhore, të lutem që mund të jenë në pozicione të ndryshme në KQV, në KZAZ, në QV, që kanë peshën e tyre ditën e votimit sipas proceseve respektive, pra të tillë e kanë valencën dhe këta dhe janë administratë zgjedhore e KQZ-së. Pra këtë retorikë e kishim në kuadër të ruajtjes së standardit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Kemi çështje të tjera jashtë rendit të ditës kolegë? Jo. Atëherë fillojmë me shqyrtimin e aktit që kemi në rendin e ditës. Paraprakisht unë kam një pyetje për ju. Ne kemi një draft të ardhur në datën 4 dhjetor, i cili në mbledhjen e datës 7 nuk u shqyrtua nga ana jonë, u shty për mbledhjen e radhës, ndërkohë na ka ardhur me email nga Komisioneri një draft me disa ndryshime, në vlerësimin tuaj duhet të fillojmë me këtë draftin e fundit për shqyrtim?

Znj. P. Doçaj: Do të duhet të fillohet me këtë akt, duke qenë se është...

Znj. I. Nano: Pra është vullnet i propozuesit ai që na ka ardhur me email?

Znj. P. Doçaj: Po.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Dakord.


Znj. P. Doçaj: Duke qenë se ne jemi personat e autorizuar prej tij, me një autorizim, patjetër që ne do...

Znj. I. Nano: Dakord. Atëherë fillojmë shqyrtimin në parim të projektvendimit për “Rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë vendit”. Në këtë fazë për procedurë, së pari e marrin fjalën anëtarët e Komisionit Rregullator, më tej subjektet, përfaqësuesit e partive politike. Në parim kush e do fjalën kolegë? Z. Çaka!

Z. D. Çaka: Po faleminderit zonja Kryetare! Do doja që të kisha një informacion nëse është e mundur nga përfaqësuesit e administratës. Pra, janë sjellë dy propozime, të cilat kanë sjellë një ndryshim, dy ose tre ndryshime në draftin që sapo ju cituat. Pyetja ime është, cila ka qenë nevoja në vlerësimin e Komisionerit, nëse ju mundet ta përcaktoni për të bërë këto ndryshime? Më saktë në pjesën e Komisionit që do të marrë, do të bëjë numërimin e votave pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve? Sepse në vlerësimin tim personal dhe akti i parë, i sjellë nga Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve, i propozuar me atë vendimmarrje ishte në rregull. Çfarë risie ka ky propozimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me këtë pikë?

Znj. I. Nano: Zonja Josifi!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. J. Josifi: Atëherë përtej projektvendimit të propozuar zyrtarisht në thirrjen e Komisionit Rregullator në fillim të muajit, Komisioneri ka përcjellë herën e parë përmes Sekretares së Përgjithshme, herën e dytë përpara, dy ditësh në mos gaboj, vetë me email. Dy ndryshime, po i quaj kështu, e para adresonte çështjen, pikën e fundit të kërkesave të ngritura në mbledhjen tuaj, të datës 7 dhjetor, të ngritur nga Kryetarja e Komisionit Rregullator, që lidhej me administrimin e katër llojeve të kutive, kur mbylleshin ato dhe kur do të duhet të kalonin në VNVJ dhe për këtë në secilin nga seksionet, ku përshkruhet administrimi i materialit zgjedhor, për secilën nga katër kutitë është ndryshuar pika e parë, pra paragrafi, me qëllimin për të qartësuar këtë gjë në vijim të kërkesës së zonjës Nano. Ndryshimi i dytë që është ai i para dy ditëve, për të shtuar anëtarë vëzhgues në komisionin që ju përmendët, nga ana e Komisionerit vjen si pasojë e kërkesës ose e sugjerimit, e propozimit të z.Çakaj, të bërë në mbledhjen e datës 7 dhjetor, ai në atë rast, citoj se mundet të merret parasysh që të ketë vëzhgues, pra partitë kryesore të kishin në këtë komision njerëz të tyre, ishte pjesë e diskutimit që u bë pa kaluar para vendimmarrjes për ta nxjerrë projektvendimin nga rendi i ditës. Këto janë dy ndryshimet në thelb, nga versioni i propozuar me shkrim.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Josifi! Zonja Vukaj, po, në parim!

Znj. H. Vukaj: Në parim ky draft, në fakt, i ardhur para dy ditësh, me ndryshimet e reja tregon dhe dëshmon që paska pasur nevojë që ende të plotësohet, nga ana tjetër pas ardhjes së parë dhe nxjerrjes jashtë rendit të ditës, ne i lamë detyra administratës, unë dhe kolegu Muharrem Çakaj, të cilat nuk rezultojnë deri më sot të jenë përmbushur. Detyrat kërkonin në lidhje me takimet që kishte zhvilluar si personi që mban marrëdhënie me të tretët, pra Komisioneri me partitë politike dhe

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

organizatat, të bëhej transparent opinioni i tyre, mendimi i tyre për ruajtjen e standardit dhe ndjekjen e frymës së Kushtetutës në lidhje me votimin, votën dhe atë si e drejtë e lirisë politike dhe nga ana tjetër të dinim si dhe ku ishte burimi i daljes jashtë parimeve, standardeve të Kodit, në raport me ambientet e KQZ-së, të cilat perceptoheshin dhe lexoheshin ndryshe nga Komisioneri dhe ndërkohë administrata e KQZ-së lexoi përsëri ndryshe nga Komisioneri dhe thamë a keni ju një dakordësi apo konsensus që ju jepte shtysën që të dilni me këtë risi përtej parashikimit që bën Kodi dhe deri më sot ne nuk gjejmë asnjë, po asnjë shpjegim dhe deklaram apo përmbajtje shkresore, dokumentare, qoftë dhe verbale nga ana e administratës që të na justifikonte të gjithë këtë afat që ajo e ka mbajtur draftin nën këtë justifikim. Nga ana tjetër, të nderuar kolegë, siç e dini ky është një akt ndër më të rëndësishmit e kësaj pakete, absolutisht që është që është akti më i rëndësishëm, i cili shkon në përmbushje të detyrës, të detyrimit, të drejtës dhe lirisë kushtetuese që buron nga neni 45 i saj, e më pas në Kodin Zgjedhor. Neni 45, në pikën 4, jo më kot, i Kushtetutës, citon se vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë, pra pikërisht, për hir të kësaj rëndësie ky draft sot duhet të ishte perfekt. Perfekt në kuptimin e gjithëanshëm, në kuptim të ruajtjes së garancive, në kuptim të materializimit të drejtë të realizimit të kësaj të drejte dhe lirie politike, si për shtetasit brenda, ashtu edhe për shtetasit jashtë, pra si në kuptimin substancial, në kuptimin formal, në kuptimin procedural. Ky akt me sa kemi parë në përmbajtjen e tij, edhe pse ka tejzgjatur në kohë nuk e ka përmbushur këtë cilësi. Jo më kot ky akt duhet të ishte i konsoliduar sepse ligjvënësi, siç e shihni në Kodin, ose e dini, në Kodin Zgjedhor e ka renditur këtë akt si një ndër aktet me rëndësi të veçantë për hir të cilësimit që ka vënë në momentin e votimit tij. Pra, është një akt, i cili duhet të miratohet me shumicë të cilësuar. Pse e ka bërë ligjvënësi këtë? Me qëllim që të gjithë ne, palët të bien dakord dhe të kenë konsensusin që ky akt, po miratohet si

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

garantues, po miratohet si akt me parime të ngritura mirë, si akt që parashikon gjithçka, si akt që siguron të drejtën dhe lirinë e votës dhe i trajton të dy palët e zgjedhësve të barabartë dhe nga ana tjetër sepse të votosh dhe të zgjedhësh nuk ka vetëm një medalje, është dhe medalja tjetër e atij që do të zgjidhet. Pra je zgjedhës, por ka dhe të zgjedhur, pra të garantojë edhe atë që pret valencën ose vlerësimin e votuesit për ta zgjedhur kandidat për t'u përfaqësuar prej tij në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Ky akt të nderuar, nuk e përcjell as këtë. Nga ana tjetër unë bashkëngjitur do të kisha preferuar, jo preferuar, se s'është preferencë, por është domosdoshmëri mendoj që të kisha një protokoll aty ku të më thuhej, ne e kemi parë dhe ne e kemi studiuar kaq mirë këtë zonjë, anëtare e Komisionit Rregullator, apo ju zotëri, sa që kemi inspektuar dhe hulumtuar dhe mbi organet të cilat, apo entet shtetërore apo private, që implikohen përmes ligjeve të tjera në këtë proces dhe detyra juaj minimalisht duhet të ishte një protokoll narrativ, i shkruar, i secilit ent apo institucion që përfshihet në juridiksionin ku ka të bëjë ose përzihet kjo e drejta e votës nga jashtë. Për shembull, në dijeninë time, në momentin kur zarfat do të zbresin, duhet një mbikqyrje dhe administrim, gjë që te ky akt nuk pasqyrohet, madje që në titull është një e metë e madhe kjo, nuk përçohet as 70% e paragrafit të fundit, pikës 4 të nenit 25/1, por është pjesore ajo çfarë keni pasqyruar në titull, për më tepër në përmbajtje është edhe në pjesore, nuk i përgjigjet as titullit, pra në dijeninë time është institucioni i doganës, i cili në zonat aeroportuale ka juridiksion dhe ka kompetenca të bazuar në Kodin e Doganave, pra Kodin doganor që mund të të ushtrojë attribute në momentin kur ia dikton Kodi, por a është garanci kjo? A është si të thuash djep apo boshllëk i mbyllur, a ka një kapak ky "gape" pra kemi gjetur, kemi valvulën dhe nga ana tjetër kemi edhe mekanizmin që nuk e lë valvulën të shfryjë, pra a e kemi gjetur këtë duke studiuar këtë rrethanë? Po policia, si implikohet policia, kush është protokollit i cili na sjell

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

prezent se cilat janë detyrat ligjore të policisë aty, me qëllim që të dimë që ky standard garancie duhet të kihet parasysh edhe për këto dy institucione, të cilat duhen përfshirë këtu, në këtë akt, qoftë si shtojcë, qoftë si një pjesë e një dispozite të veçantë, sesi do jetë sjellja e tyre në raport me këto zarfa, sepse zarfat nuk vinë të dedikuar në atë, kolipostën specifike, zarfa për të votuar, por do të vinë si zarfa të cilët janë në materiale kolipost por të përzier dhe me të drejtë një nëpunës, zyrtar i një institucioni tjetër mund të ndërhyjë sepse ia dikton ligji. A keni marrë ju masa në këtë këndvështrim? Mua nuk më rezulton sepse s'ka asnjë material të studiuar nga jua po ndonjë propozim konkret? Nga ana tjetër, përveç se nuk pashë ruajtjen e standardit këtu, nuk kam parë as edhe qasjen më të vogël që të njëjtat mekanizma dhe organe që intervenojnë dhe vihen në lëvizje për realizimin e votës brenda, të përdoren për votën nga jashtë dhe kjo është për t'u shqetësuar në fakt sepse vota ka të njëjtën valencë, kur numërohet, numërohet njësoj apo jo? Sjell të njëjtën vlerë, atëherë pse duhet të diskriminojmë pozitivisht apo negativisht grupet? Kjo mungon dhe duhet riparë, pra nuk jep garanci në momentin se si, në mënyrën sesi është shkruar. Për më tepër, po theksoj dhe njëherë nuk kemi asnjë shpjegim se ku e ka gjetur autorizimin Komisioneri që përmes këtij propozimi nxjerr nga konturet e parashikimit ligjor depozitimin e zarfave në KQZ dhe më pas vlerësimin e tyre jashtë, pra jashtë KQZ-së. Në ambientet e KQZ-së thotë Kodi, ndërkohë që në draft Komisioneri ka marrë masa që përmes vënies në dispozicion nga Prefekti ta nxjerrë procesin jashtë KQZ-je, këtë nuk e kemi as të argumentuar, as të justifikuar. Unë për momentin kaq kam, por do vijoj me pyetje të tjera sipas procedurës.

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Z. M. Çakaj: Po, atëherë unë e kam lexuar me vëmendje projektvendimin, më duhet të them që parimisht, sigurisht që jemi dakord me një projektvendim, i cili do të materializojë parashikimet e nenit 25/1, pika 4, paraprakisht. Unë, përpara se të jap një opinion, vlerësimin tim për këtë projektvendim, kam disa pyetje për administratën. Në momentin që është hartuar ky projektvendim besoj është marrë në konsideratë neni 25/1, pika 4. Çfarë parashikon pika 4? Pika 4 parashikon dy përcaktime kryesore, së pari parashikon faktin që vendi i administrimit dhe numërimit të votave do të jetë në ambientet e KQZ-së, më saktë KQZ, këtu. Ndërkohë në projektakt është propozuar me sa duket nuk i disponojmë ambiente të tilla dhe është propozuar që t'i drejtohem Prefektit të Tiranës, në mënyrë që të na vëri në dispozicion një ambient ku do të identifikohet, ku do të ngrihet VNVJ-ja apo jo së pari? Pra, në projektakt, në kuptim të mbarëvajtjes dhe mirëadministrimit të procesit na rezulton që kemi dalë nga koncepti strikt i ligjit dhe kemi bërë një interpretim më të zgjeruar, pra ambienti i KQZ-së do të jetë dhe një ambient i cili do na vihet në dispozicion nga institucionet përkatëse, në rastin konkret nga Prefekti i Tiranës. Ndërkohë jam i paqartë pse nuk është ruajtur i njëjti standard kur themi administrata e KQZ-së dhe do të doja një qartësi, me administratë e KQZ-së e cila do ta administrojë, numërojë votat, të vlerësojë e të gjitha, ju nënkuptoni vetëm administratë e KQZ-së, pra kam këtu organigramën e KQZ-së, e cila përbëhet nga 95 punonjës, nënkuptoni këtë administratë apo nënkuptoni dhe personel të rekrutuar? Do të doja, se në varësi të draftit që është propozuar do të doja një përgjigje shteruese.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj!

Znj. J. Josifi: Mund ta nis përgjigjen nga...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Vetëm mund të them diçka, pastaj vijojmë me pyetjet që u janë drejtuar. Nga diskutimi në parim i zonjës Vukaj, vlerësoj që një pjesë e atyre çka u diskutuan janë ezauruar me aktin për votimin, procedurat e votimit nga jashtë, pra deri në momentin që votat shkojnë, vinë dhe kemi regjistrimin e atyre votave që kanë ardhur, e dokumentacionit zgjedhor është ezauruar tashmë me aktin për procedurat e votimit, madje kemi dhe ndarjen në ato që i kemi kuti votimi. Pra në këtë moment, pra marrjen në dorëzim...

Znj. H. Vukaj: Procesi nuk është administruar aty, procesi...

Znj. I. Nano: Në momentin që operatori, të lutem...

Znj. H. Vukaj: Procesi i administrimit fillon që nga zbritja nga avioni, procesi i administrimit.

Znj. I. Nano: Më fal, në aktin për procedurat e votimit...

Znj. H. Vukaj: Nuk ke parashikuar asgjë aty...

Znj. I. Nano: I kemi të parashikuara edhe kur...

Znj. H. Vukaj: Jo nuk është.

Znj. I. Nano: ...por në fakt ky është vendimi që kemi miratuar.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Po mirë pra se është një moment tjetër administrimi ky që duhet të mbarti ky akt dhe duhet të trajtojë ky akt.

Znj. I. Nano: Me aktin e shkuar, pra me aktin për procedurat e votimit kemi shkuar deri në procesin kur vinë votat, dokumentacioni zgjedhor, më mirë të themi nga operatori i shërbimit postar në ambientet e KQZ-së, madje edhe regjistrohen dhe futen në ato që quhen kuti të votimit, kështu i kemi quajtur, kutitë e votimit nga jashtë. Procesi dhe proceset që përmban ky akt që kemi sot në shqyrtim, që lidhen me numërimin, administrimin, tabulimin, dokumentacionin përkatës fillojnë nga ora 7 e mbrëmjes së datës 11 maj e më tej, kështu që çështjen, posta, dogana, aeroporti, policia...

Znj. H. Vukaj: Po flasim për momente të ndryshme, të lutem, nëse ju keni dijeni se cila është, cili është juridiksioni, kompetenca e doganave dhe e policisë...

Znj. I. Nano: Jo, jo e kemi mbaruar, e kemi ezauruar...

Znj. H. Vukaj: Po jo s'e kemi të ezauruar atë gjë ne, mbartet në këtë akt.

Znj. I. Nano: Në aktin e numërimit?

Znj. H. Vukaj: Ky akt buron nga 25/4, paragrafi i dytë.

Znj. I. Nano: Në aktin e numërimit, jo.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Akti i numërimit zonjë nuk mund të jetë akt numërimi pa qenë administrimi. Administrimi është tjetër administrim ai dhe tjetër administrim duhet...

Znj. I. Nano: Po pra, ç'punë ka dogana këtu, në këtë moment, mbasi kanë ardhur në ambientet e KQZ-së apo në një ambient tjetër, kanë kaluar nga dogana, nga posta, kanë ardhur te ne.

Znj. H. Vukaj: Folëm për dy standarde dhe folëm për organe të njëjta, të cilat duhet të realizojnë këto dy procese, si atë nga jashtë, si atë nga brenda. KZAZ-ja zonjë, a kryen një proces për votimin nga brenda? KZAZ-në nga jashtë si do konsiderosh, a do kryejë një proces kjo KZAZ-ja?

Znj. I. Nano: Jemi në proces numërimit tani, jo proces votimit, është mbyllur ai.


Znj. H. Vukaj: Po pra po, në kontekstin e barazisë e administron atë kutinë, si e administron kutinë e votës?

Znj. I. Nano: Siç e kemi miratuar.

Znj. H. Vukaj: Numëruesi nga brenda si administron?

Znj. I. Nano: Derisa të vijë në momentin pas orës 19.00 e kemi te akti i kaluar, kur vimë këtu është këtu i normuar.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Po jo pra mos e merrni kaq lehtësisht se s'kemi të bëjmë me të njëjtin administrim që po qasemi, për cilin akt bëni fjalë që të marrim dhe ne vesh?

Znj. I. Nano: U nisa nga një nga ato diskutimet tuaja që thatë polici, doganë, kufiri.

Znj. H. Vukaj: Më thuaj cilin, jo pra s'keni ndjekur ligjëratën komplet.

Znj. I. Nano: Për pjesët e tjera le t'ju përgjigjet administrata, për këtë pjesë nuk e kemi miratuar.

Znj. H. Vukaj: Të lutem, nuk e keni ndjekur logjikën sepse...

Znj. I. Nano: E kam ndjekur maksimalisht.

Znj. H. Vukaj: Jo nuk e keni ndjekur, më fal po të sqaroj.

Znj. I. Nano: Më fal po ç'punë ka dogana në këtë sekond, tek akti i numërimit? S'ka punë dogana.

Znj. H. Vukaj: Akti i numërimit...

Znj. I. Nano: Te akti i numërimit?

Znj. H. Vukaj: Zonjë si e ke titullin e këtij akti?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Ta lexoj njëherë si e ka, ta lexojmë titullin e aktit!

Znj. H. Vukaj: Po.

Znj. I. Nano: Unë e lexova, e kam lexuar, në momentin...

Znj. H. Vukaj: Titulli i aktit është i metë.

Znj. I. Nano: Do të ndryshojmë titullin, ta ndryshojmë?

Znj. H. Vukaj: Po s'kemi arritur atje.

Znj. I. Nano: Po pra.

Znj. H. Vukaj: Po diskutimin tim dhe logjikën që ngre, nuk mund të ndërhysh.

Znj. I. Nano: Po nuk është këtu në këtë moment.

Znj. H. Vukaj: E dimë se çfarë është.

Znj. I. Nano: Patjetër, unë thjesht që ne kemi miratuar një akt për procedurë të votimit, pra kemi mbyllur me vendimmarrje madje.

Znj. H. Vukaj: Rregullat për administrimin, vëzhgimin, procesit të numërimit, numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës e kështu me radhë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Ju shkoni te titulli tani.

Znj. H. Vukaj: Po te titulli fillon, brumi i aktit, te titulli, do të marrësh të gjithë

Znj. I. Nano: Jemi në diskutimin në parim, kemi pas dhe raste që kemi ndryshuar titullin.

Znj. H. Vukaj: Po pra diskutimi në parim. Po diskutojmë për këtë akt te diskutimi në parim...

Znj. I. Nano: Kur të vimë te diskutimi nën për nën e ndryshojmë titullin

Znj. H. Vukaj: Unë ndaj e ngrita te administrimin dhe implikova edhe këtë dijeni, doja që ta kisha marrë nga administrata këtë dijeni.

Znj. I. Nano: Për pjesë tjetër padyshim. Unë doja të ndërhyja që aktin për votim e kemi miratuar...

Znj. H. Vukaj: Për të ditur sesa të sigurta do jenë ato vota.

Znj. I. Nano: ...kështu që unë kaq e kisha diskutimin tim, mund të vazhdojnë diskutimet e kolegëve...

Znj. H. Vukaj: Diskutimin në ndihmë të administratës nuk e zgjidhni...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Jo, nuk po ndihmoj njeri.

Znj. H. Vukaj: ...detyra ka administrata...

Znj. I. Nano: Po ua konfirmoj dhe njëherë se cfarë kemi miratuar.

Znj. H. Vukaj: ...po jua kujtoj se cfarë detyre i kemi lënë administratës, administrata nuk është përgjegjur, ju s'i ndihmoni dot administratën. Pyetjeve të mia u japin...

Znj. I. Nano: Nuk marr përsipër të ndihmoj, as të rëndoj njeri as me pyetje, as me komente.

Znj. H. Vukaj: ...ju nuk e dini se përse, pikërisht pra nuk po i rëndojmë askënd, vetëm thjesht po i drejtojmë ca pyetje dhe presim përgjigje nga administrata. Meqenëse e kam thënë dhe herë tjetër, nuk kemi një administratë të dedikuar, të posaçme, të dedikuar, tonën si trupë që ta vëmë në lëvizje apo t'i japim detyra, kjo administratë...

Znj. I. Nano: E kemi administratën e KQZ-së e kemi në dispozicion...

Znj. H. Vukaj: Presupozohet që e ke, por në fakt nuk rezulton ashtu.

Znj. I. Nano: Atëherë për pyetjet e drejtuara nga zonja Vukaj dhe zoti Çakaj, kush dëshiron? Zonja Josifi!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. J. Josifi: Atëherë lidhur me pyetjen e parë që lidhet me vendin e numërimit dhe vlerësimin të votave nga jashtë që ishte në fakt një çështje ngritur në mbledhjen tuaj të datës 7 dhjetor. Ne sërish në datën 7 dhjetor, ju kishit pesë kërkesa në mosgaboj, u përgjigjëm katër prej kërkesave tuaja me shkrim, me email lidhur me këtë pikë, përgjigja jonë ishte, thjesht për transparencë nëse mundem ta lexoj: “Aktualisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka në administrim të tij vetëm një ambient, selinë qendrore, që është kjo që jemi këtu sot edhe në administrim me VKM nr.501, të datës 30 korrik 2014, në administrim, si dhe një truall të dhënë në administrim të KQZ-së me VKM-në 480, të 24 korrik 2024”. Pra rishtazi, qartësisht për ne propozimi në projektvendim për VNVJ-në pikërisht u bë i tillë sepse është objektivisht e pamundur që administrimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë të kryhet në ambientet e KQZ-së, në kuptim të hapësirës, jo të asnjë gjëje tjetër, në projektvendim...

Znj. H. Vukaj: Ne nuk duhet të dilnim jashtë parashikimeve të ligjit, ndërkohë që Kodi pësoi ndryshime, pse s’i thatë ligjvënësit, që shiko ne s’kemi ambiente, më rregulloni këtë fashë, të përkthyer...

Znj. J. Josifi: Ju lutem më lini ta mbaroj!

Znj. H. Vukaj: Një moment të lutem. Zonjë për protokoll ka një rend dhe hierarki. Atë e kemi parë, ne nuk morëm atë përgjigje çfarë ju adresuam, të na tregoni se çfarë keni në inventarin tuaj!

Znj. J. Josifi: Ju lutem në përgjigjen tonë ne nuk thamë vetëm këtë, më lejoni ta mbaroj.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*


Znj. H. Vukaj: Po e dimë përgjigjen tuaj, ndaj kolegu Çakaj dhe unë ju adresuam një email tjetër, se s'morëm përgjigje.

Znj. J. Josifi: Jo, nuk na keni shkruar email tjetër.

Znj. H. Vukaj: Është i datës 16.12.24. Ambienti i KQZ, i shkruar në mënyrë literale, ambient i KQZ-së dhe ambient i KQZ-së është ai që ka në domein dhe në inventar KQZ-ja, dakord. Nëse ju kuptoni ndryshe nuk mundet kurrsesi që ta keni këtë ambient ndryshe, me votën tonë, kaq e thjeshtë është.

Znj. J. Josifi: Dakord, këtë po ju sqaroja, KQZ-ja nuk e ka në inventar këtë godinë, nuk e ka, nuk është ambient në pronësi të KQZ-së, duke mos qenë i tillë, ne nuk abstraguam nga ligji, ne iu përmbajtëm, sërish në parashikim të Kodit Zgjedhor, të neneve 93 dhe 94 dhe propozuam si VNVJ një ambient ekuivalent që plotëson të njëjtat kushte ligjore dhe ofron të njëjtat garanci si të gjithë vendet e tjera të numërimit të votave nga brenda vendit dhe sërish ju thamë se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kur të vijë momenti, sipas afatit të propozuar nga ne, që është 40 ditë përpara datës së zgjedhjeve, caktohet vendi i numërimit të votave nga jashtë, ky vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në mos gaboj në këtë rast është i Komisionerit për caktimin e ambientit do të konsultohet me të gjitha palët në këtë moment dhe me të njëjtat modalitete me të cilat konsultohet edhe caktimi i vendeve të numërimit të votave për procesin e numërimit të votave brenda vendit. Gjithsesi nëse ju e vlerësoni të tillë dhe e gjykoni të tillë dhe mendoni që ky numërim do të duhet patjetër të ndodhë në këtë godinë, atëherë ne

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

do të duhet të marrim gjithë masat logjistike dhe organizative ta bëjmë në këtë
godinë. Nëse ju do e vlerësoni kështu, këtu është...

Z. M. Çakaj: Unë jam shumë i qartë dhe shumë i sqaruar...

Znj. J. Josifi:...pse ne kemi bërë këtë propozim, pra cilat ishin kushtet objektive që
na shtynë të bënim këtë zgjedhje...

Z. M. Çakaj: Zonja Josifi, në vijim të pyetjes që ju bëra, pyetjes së parë jam shumë
i qartë, shumë i sqaruar dhe më duhet të theksoj që jam personalisht 100% dakord
që ju e keni bërë, trumbetuar në mënyrë të zgjeruar, me shkaqe objektive
dispozitën 25/1, pika 4 e Kodit Zgjedhor, jam 100% dakord dhe personalisht dhe
unë drejt kësaj zgjidhje do të shkoja, madje kur jeni referuar standardit të
numërimit të votave nga brenda, neni 93, neni 94 ekzaktësisht dhe unë kështu do të
kisha vepruar. Kalojmë te pyetja e dytë, po pres përgjigjet që të jap vlerësimin.

Znj. J. Josifi: Në mos gaboj pyetja e dytë ishte nëse keni përdorur këtë abstragim
për vendin e numërimit, përse nuk keni përdorur thatë ju nëse e kam kuptuar saktë
po këtë abstragim, po interpretim të zgjeruar edhe kur vjen puna për numërimin që
kryhet nga administrata e KQZ-së, në këtë rast ne i kemi të gjitha kushtet objektive
ta kryejë administrata e KQZ-së dhe nuk kemi propozim tjetër nga asnjë palë në
fakt, kundërshtim me këtë propozim tonin apo në përputhje me Kodin Zgjedhor,
pra një propozim të ndryshëm nga ky i yni në përputhje me Kodin Zgjedhor përveç
atij të anëtarëve vëzhgues në komision dhe anëtarëve vëzhgues në GNVJ.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Z. M. Çakaj: Supozojmë, nuk e dimë, supozojmë në bazë të Censurit të fundit rezulton se shtetas shqiptarë me banim jashtë vendit duhet të jenë diku, në mos gaboj te 1.7 milion, nga të cilët duhet të jenë me të drejtë vote 1.2, 1.3, 1.4. supozojmë se do të votojnë vetëm 20% e këtyre, supozojmë, që do të thotë 250 000 votues nga jashtë, po edhe 150 000. Në nenin 127 të Kodit Zgjedhor parashikohet që afati maksimal për nxjerrjen dhe tabelimin e rezultateve është jo më vonë se ora 22.00 e ditës së nesërme të votimit, a ka mundësi, duke marrë në konsideratë dhe parashikimet e Kodit Zgjedhor për numrin maksimal të kutive të votimit që mund të numërojnë një grup numërimi. Kemi 12 grupe numërimi, a ka mundësi reale, objektive që 12 grupe numërimi të përbërë nga dy anëtarë, pra 24 personel i KQZ-së, të tabelojë, të vlerësojë, të administrojë brenda këtij afati kohor të parashikuar në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, të ditës së nesërme, ora 22.00 e ditës së nesërme, ka mundësi të arrihet kjo objektivisht?

Znj. J. Josifi: Nëse kjo arrihet objektivisht për procesin e numërimit të votave brenda vendit, patjetër do të arrihet objektivisht edhe për numërimin e votave jashtë vendit dhe numri i grupeve të numërimit do të jetë ai që do të përcaktojë. Mundet që të kemi për një qark më pak vota të ardhura, pra vota nga jashtë po flasim, mundet për një qark tjetër besojmë kështu do të jetë, duhet të ketë më shumë dhe për pasojë do të caktohen grupe numërimi në raport me numrin e fletëve që do të vlerësojnë.

Z. M. Çakaj: Atëherë më lejoni të them diçka, meqë kam një çikë eksperiencë, unë dhe kolegu Çaka, atëherë kjo është e pamundur objektivisht të arrihet, është e pamundur, të paktën për KZAZ-të e Tiranës, si dhe KZAZ-të e qyteteve kryesore, është e pamundur të respektohet ky afat kohor. Në këto kushte unë do të vlerësoja

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

që duke respektuar normën e parashikuar nga ligjvënësi, neni 25/1, pika 4, KQZ-ja të rekrutojë personel, i cili duhet të ketë eksperiencë, në administrim zgjedhor dhe sigurisht ky personel do të ketë në përgjegjësi të KQZ-së dhe do të kryejë gjithë detyrat, do të trajnohet nga KQZ-ja të gjithë detyrat, e ngarkuara në kontratën individuale në përshkrimin e marrëdhënieve të punës, në mënyrë që procesi të jetë i shpejtë, objektiv dhe sigurisht të ruhet standardi që ne të pestë kemi vendosur në aktin pararendës për votimin. Vota e shqiptarve është e njëjtë si brenda dhe jashtë vendit, rrjedhimisht edhe procesi i administrimit, procesi i numërimit, procesi i vlerësimit dhe tabulimi i rezultateve duhet të jetë i njëjti standard zgjedhor, ky është vlerësimi im personal, me keqardhje konstatoj që nuk e gjej të materializuar në këtë draft, kështu që unë vlerësoj bashkë me kolegët do të duhet ta ripunojmë siç e shpreha dakordësinë në parim për këtë akt, do të duhet ta ripunojmë këtë akt, në mënyrë që ky të vijë në standardet e parashikuara nga Kodi Zgjedhor, nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të kemi një proces objektiv dhe të realizueshëm, siç është procesi i regjistrimit, të jetë dhe procesi i votimit, edhe procesi i administrimit dhe numërimit, dhe tabulimit të rezultateve. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit z. Çakaj! Në parim z. Çaka!

Z. D. Çaka: Doja të bëja një pyetje për administratën, se i dëgjova dhe diskutimet, edhe të kolegëve. Unë personalisht mund të kem tjetër vlerësim se çfarë mund të quhet ambient i një institucioni, deri në momentin që ky institucion mund ta ketë marrë në një nga format që lejon edhe Kodi Civil, që mund të jetë me kontratë, blerje, shitje ose në akte të ndryshme qiraje, huapërdorje dhe në vlerësimin çdo ambient i cili përdoret nga një strukturë e caktuar është ambient i asaj strukture dhe

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

jo detyrimisht duhet të jetë në pronësi, por e tejkaloj vlerësimin mund të shkoj pastaj edhe nëpër diskutime kur të vijë puna në diskutimin nen për nen. Kam një pyetje të drejtpërdrejtë sepse nuk jam shumë i parimit që në qoftë se nuk gjendet një zgjidhje për një situatë, atëherë pse mos të përdoret i njëjti standard dhe për një situatë tjetër. Nëse është e mundur nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të përdorë këtë ambient në të cilin ne zhvillojmë mbledhjet për të bërë numërimin, administrimin, numërimin dhe vlerësimin e votave pa pasur nevojën për të marrë një ambient tjetër në çfarëdo lloj forme që e lejon legjislacioni që lidhet me qarkullimin civil? Po flas në konceptin fizik, teknik, praktik.

Znj. J. Josifi: Vetëm një moment meqë e kishit në kuptimin praktik, jo ligjor. Në kuptimin praktik do të ishte e pamundur sepse paramendoni që dita e zgjedhjeve dhe dita pas ditës së zgjedhjeve, i vetmi ambient i hapur, pak më i madh, salla më e madhe që kjo godinë disponon është kjo që jemi sot këtu dhe kjo është e njëjta sallë që përdoret po ashtu për mbledhjet e organeve drejtuese, edhe për gjithë komunikimin me publikun edhe me zgjedhësit, që do të thotë ne do të duhet ta bllokoni tërësisht këtë sallë për të realizuar procesin e numërimit, por edhe nëse do të bënim kështu, do të gjenim një zgjidhje alternative për mbledhjet publike, të atyre dy, tre ditëve për organet drejtuese. Kjo sallë edhe më vete nuk është mjaftueshëm e madhe sepse sikur minimalisht të mendojmë që do të ketë një tavolinë numërimi për secilin qark, po marrim minimalen do të duhen 12, shtojmë vëzhguesit këtu që do të jenë në tryezën e numërimit si vëzhgues, shtojmë vëzhguesit në vendin e numërimit, meqë po supozojmë që ky do të jetë një vend numërimi, është e pamundur që kjo sallë ta ketë atë kapacitet nga pikëpamja praktike, prandaj erdhëm me këtë propozim.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Kemi bërë numërime këtu, janë bërë nga administrata.

Z. D. Çaka: Sa tavolina janë përdorur këtu për rinumërimet të një qarku të plotë, i cili mund të ketë po atë numër zgjedhësish...

Znj. P. Doçaj: Do të penalizonim pastaj edhe proceset e tjera të votimit nga brenda, se një...

Znj. I. Nano: Një pyetje, sa tavolina janë përdorur këtu?

Znj. P. Doçaj: Megjithatë nuk do të përbënte problem kjo në rast se do të mund ta shikonim dhe nga pikëpamja administrative, edhe pse ne e kemi parë në këtë këndvështrim dhe në referim të nenit 93 siç u shprehët edhe ju, duke qenë se kemi marrë në konsideratë edhe faktin që nuk mund të përdorim këtë ndërtesë që përdor dhe administrata publike. Në interpretim dhe të kësaj por edhe të pikëpamjes logjistike kemi arritur në atë konkluzion. Megjithatë nëse ju do ta shihni të arsyeshme që të përdorim këto ambiente, patjetër që do...

Z. D. Çaka: Pyetja ime ishte që do të jetë sepse duke qenë se kemi...

Znj.J. Josifi: Dhjetë tavolina.

Z. D.Çaka: ...duke qenë se kemi pra një artikulum të mendimeve të ndryshme që mund të ekzistojnë, pra mundet të ndodhë që edhe ky propozim i Komisionerit mund të rrëzohet, por ne duhet ta dimë që a ekziston mundësia këtu apo jo? Kështu që...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Z. M. Çakaj: Një sekond, shiko, të marr diçka për referencë ju lutem? Atëherë për referencë...

Znj. P. Doçaj: Do të duhet që administratën e përhershme ta spostojmë...

Z. M. Çakaj: Po, pra jam dakord me propozimin e znj. Josifi. Atëherë për referencë po marr një qark, qarku Mat, qarku i Durrësit ka 250 000 votues, ka pesë KZAZ, me nga gjashtë tavolina numërimi, janë 30 tavolina numërimi. E disa kohë do procesi i numërimit? Minimalisht 28 orë, e tejkalon atë minimalisht dhe këtu jam dakord për ambientin, por duhet të jemi dakord edhe për rekrutimin e personelit, janë 60 grupe numërimi, është e pamundur me 12 grupe numërimi të administrosh ose përndryshe do na kthehet në bumerang. Në si KQZ, në duhet ta jemi të qartë se çfarë po bëjmë, ku hyjmë, ku dalim, prandaj e doja dhe Komisionerin këtu, që në datën në mos gaboj 9 shtator të këtij viti, pasi kishin hyrë në fuqi ndryshimet ligjore, unë dhe kolegja Vukaj kemi kërkuar, i kemi kërkuar Komisionerit një hartë të gjithë akteve, një projeksion, çfarë aktesh duhen, ku hyjnë, ku dalin, çfarë duhet të bëjmë për të jetësuar procesin e votës së emigrantëve. Edhe në komunikimin tonë mesa kujtohem, madje na ka bërë dhe z.Haçkaj na ka bërë dhe email, na ka kujtuar herë pas herë që po tejkaloni afatin, në vlerësimin tim projektaktet janë propozuar dhe sigurisht miratuar tej afatit ligjor të ngarkuar nga ligjvënësi, neni 24, afati ligjor ka qenë 90 ditë. Ju zonja Josifi keni vlerësim ndryshe, besoj është dhe vlerësim i Komisionerit që të paktën ky akt që merret me administrimin dhe numërimin e votave, i cili do të zbatohet nga data 11 maj e më pas është jashtë afatit 90 ditor, dakord. Mendimi ynë është ndryshe. Mendimi im është ndryshe, mendimi i Komisionerit është ndryshe, supozojmë se

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

është kështu, atëherë hajde e marrim kohën e nevojshme, ta bëjmë këtë akt siç duhet dhe të qartësojmë dhe të zgjidhim rrisqet e mundshme, duke filluar dhe nga këto rrisqet praktike të trajtimit të çështjeve, të zgjidhjes së situatave, pra t'i identifikojmë dhe t'i zgjidhim në mënyrë sa më objektive, sa më praktike sepse përndryshe do ndodhemi në një kolaps që s'e kishim menduar dhe sigurisht referenca këtu duhet të jetë vota nga brenda, mënyra se si trajtohet administrohet vota nga brenda. Sa mirë ju e zgjidhët procesin e ambientit të KQZ-së duke marrë për referencë në mënyrë ideale trajtimin nga brenda. E njëjta gjë, e njëjta zgjidhje duhet të jetë edhe këtu. Nuk i ka mundësitë reale KQZ-ja të trajtojë 200 000 vota, të administrojë, të vlerësojë, numërojë, nuk i ka, nuk ndodh, nuk respektohet! Pra do jetë një proces i gjatë, një proces i lodhshëm, një proces i pamundur teknikisht dhe sigurisht do ngrejë hije dyshimi mbi të gjitha palët, nga të gjitha palët politike, aktorët, faktorë, parti të reja, parti të vjetra dhe do i drejtojë shigjetat nga KQZ-ja se pse e keni miratuar? Ne mbi të gjitha, ne kolegë të Rregullatorit, pse e kemi miratuar një projektakt, kur mund ta parashikonim? Hajde t'i japim zgjidhje këtij procesi, ky projektakt nuk ofron zgjidhje.

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Unë, në vështrim të të gjithë vullnetit që kemi, bonsensit të shprehur që në krye të herës, në ditën një të procedimit me këto akte që kemi thënë, hajde punojmë në mënyrë dinamike dhe të miratojmë aktet dhe ta bëjmë këtë proces, si asnjë proces tjetër, pra që të jetë efektiv dhe garantues. Kolegu Çaka u prir dhe gjeti argumenta për t'i dhënë një qasje pozitive këtij ambienti që KQZ-ja po kërkon nga jashtë për ta realizuar procesin apo jo? Sepse ne nuk duam që të dështojë procesi kurrsesi, ndaj po diskutojmë këtu, po hedhim, po presim, me

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

qëllim që të konsolidojmë gjënë. Gjeti qasje pozitive dhe iu referua Kodit Civil, përdori kontratën, efiteozën, etj, qiranë e kështu me radhë. Në këtë kontekst hajde e gjejmë qasjen pozitive për të ndryshuar atë, rëndësinë e ngushtë që keni ju nga literalizmi i administratës së KQZ-së, hajde gjejmë qasjen pozitive dhe e shikojmë me këtë sy, të kontratës, të rekrutimit provizor, të marrjes përkohësisht të disa punonjësve, të cilët me trajnimin dhe certifikimin tuaj do të jenë të aftë t'i kryejnë të gjitha proceset. Në momentin që ju i keni besuar një proces kaq të rëndësishëm, si ai i PER-it disa operatorëve, po si, nuk mund t'i besohet procesi i numërimit të votave stafëve zgjedhore, të cilat janë administratë e KQZ-së dhe për këtë kam bindje, të cilat kanë një përvojë gati 30 vjeçare? Po, padiskutim që po dhe kjo është për mua mendoj që është disi çënuese dhe fyese dhe për partitë politike, pra po vini në dyshim ju aftësitë dhe integritetin e partive politike për ta bërë si të gjitha herët këtë gjë? S'mundemi ne të kemi dy standarde të ndryshme. Nga ana tjetër, më bëri përshtypje fakti që me shumë të drejtë dhe racionalitet zonja Doçaj tha që ç'do bëjmë ne, tha këtë stafin e KQZ-së do të duhet ta heqim këtu. Po pikërisht pra sepse stafi i KQZ-së nuk mund të shndërrohet, edhe të duam ne, megjithë dëshirën e ne të pestëve, nuk mund të shndërrohet në numërues sepse ka të gjithë punët e tjera për të kryer sipas detyrave që kontrata e tyre e punës i dikton, përndryshe procesi do të dështonte ky brenda dhe hajde të nxjerrim të ndritur procesin nga jashtë! Prandaj ne zotërinj dhe zonja duhet të kemi të gjithë bonsensin për ta parë sensin më pozitiv të mundshëm të realizimit të gjësë, jo të ngecjes dhe ku di unë të gjetjes së ca mekanizmave, të cilat e bllokojnë këtë proces, nuk mund ta bllokojmë në mënyrë të njëanshme, nuk mund të stisim në mënyrë të njëanshme dhe as të vendosim ca rregulla sa për sy e faqe, po duhet të vendosim rregulla që i bind. Minimalisht të dyja forcat apo partitë politike kryesore apo dhe partitë e tjera dhe çdo të interesuar, duhet ta bindim, që po ky është një akt i shkruar dhe garantues

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

nga fillimi deri në fund dhe me këtë ne absolutisht do të merrnim të gjithë pëlqimin dhe do të dilnim të nderuar nga kjo. Ndaj sërish po e theksoj, i mbetem padiskutim parimit dhe vlerës që ka ky akt, por për sa i përket përmbajtjes hajde të ulemi ta draftojmë, ta rishikojmë, ta rishikoni, të diskutojmë, të marrim dhe opinione të tjera, të cilat i japin edhe konstruktivitet më shumë draftit dhe kështu ne themi se e mbyllim paketën me sukses. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Zoti Çaka, pastaj kam dhe unë diçka.

Z. D. Çaka: Unë jam absolutisht dakord që edhe administrata këto diskutime të mundet t'i vlerësojë për t'i akomoduar sa është e mundur, kuptohet pastaj do jetë në vlerësimin tonë, por nuk jam shumë dakord me pjesën e shtyrjes pafund të miratimit të këtij akti. Është një akt të cilin kemi mbi një muaj e gjysëm të cilin e diskutojmë brenda dhe jashtë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe me të drejtë sepse është një akt i cili është shumë i rëndësishëm dhe kërkon sa më shumë mendim, sa më shumë kontribut, por në vlerësimin tim personal do të vlerësoja që është afati i fundit të cilin ne mund ta miratojmë këtë akt është nesër, nuk mundet ta shtyjmë në pafundësi miratimin e aktit. Kështu që nëse do të kishte ndonjë dakordësi nga ana jonë, do të isha që Komisioni dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të mundësonte, nëse e vlerëson dhe Komisioneri për disa ndryshime, për t'i mundësuar që ne nesër të bëjmë mbledhje, jo më vonë se nesër, në vlerësimin tim, madje dhe nesër është vonë. Ne duhet ta kishim mbaruar me kohë këtë akt duke pasur parasysh dhe procese të tjera të cilat paraprijnë procesin e votimi të votuesve nga jashtë. Kështu që mendoj që jemi në limite kohore dhe nuk kemi më luksin për të bërë shtyrje të pafundme të mbledhjeve tona për të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

akomoduar kërkesa të cilat, gjithmonë nga ana jonë po vazhdojnë, duke përfshirë dhe veten time.

Znj. H. Vukaj: Pra ju po thoni që janë me pa të drejtë këto z. Çaka?

Z. D. Çaka: Në përshtypjen time...

Znj. H. Vukaj: S'jemi në kushte luksi këtu z. Çaka sepse të rrish dy orë këtu dhe të rrish edhe disa seanca të tjera z. Çaka...

Z. D. Çaka: ...nuk po, ju lutem, patjetër.

Znj. H. Vukaj: Nuk është luks kjo, kjo është konvaleshencë!

Z. D. Çaka: Ju lutem, atëherë nuk e thashë këtë, pikërisht përderisa nuk është luks, mundet të punojnë të gjithë për ta bërë të mundur deri nesër këtë akt, se nuk jam absolutisht dakord personalisht që ne të shtyjme pafundësisht aktin, është e pamundur, shtyj, shtyj...

Znj. I. Nano: Kam vetëm një koment, mund të mbarojmë se jemi...

Z. D. Çaka: ...hajde e bëjmë propozimet konkrete pastaj i hedhim në votim edhe i shqyrtojmë se ne po shtyhet disa herë dhe nuk është se kemi po një draft ndryshe, po e njëjta gjë vjen, me ndonjë ndryshim të vogël dhe prapë duhet bërë i njëjti diskutim. Nuk e shoh shumë rezultative këtë mënyrë sesi...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Atëherë të mbarojmë ne diskutimet në parim, pastaj ia kalojmë përfaqësuesve të partive politike dhe të shoqërisë civile, kemi diskutuar në parim po ndërkohë kemi hyrë në nenet konkrete. U sqarua çështja e vendit, si koncept i cili quhet ambient i KQZ-së, ndërkohë nga kolegët bënë vetëm pyetje lidhur me faktin se kush do të quhet administratë e KQZ-së. Ndërkohë ne kemi përfaqësues të dy partive kryesore politike, të cilët unë menjëherë pasi të mbaroj fjalën do t'ju jap atyre fjalën për të diskutuar në parim. Parimisht unë jam pro miratimit të projektvendimit përkatës, më tej në diskutimin nën për nen edhe unë kam çështjet e mia për të diskutuar, kështu që nëse znj.Xhina, z.Kaso, më tej z.Haçkaj dhe më tej nga KRIIK-u kanë diçka në parim për të diskutuar. Unë do t'i ftoja sepse në çdo rast do t'i referohem edhe koleges Vukaj, kur tha lidhur me interesin e shtuar që kanë partitë politike, të gjitha, po veçanarisht ju që jeni të pranishëm, që e dëshmoni këtë interes edhe me praninë në mbledhjet tona, në dijeninë time zyrtare me aq sa na keni informuar ju, nuk kemi qëndrime me shkrim të ardhura për KQZ-në në mënyrë që të reflektohen ose jo në një akt, kështu që pafundësisht nuk mund të themi marrim mendimet e partive, marrim mendimet e partive, lëmë kohë, i kemi prezent përfaqësuesit, do t'ju ftoja, së pari ju zonja Xhina.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Faleminderit! Atëherë në vijim të diskutimit tuaj, ne na ka ardhur një email në datë 5 dhjetor nga administrata e KQZ-së me aktin e parë për administrimin dhe numërimin e votave dhe para dy ditësh na ka ardhur një email tjetër me një draft me ndryshime. Do të ishte shumë mirë, sa ju thatë që ne do të jepnim mendim në lidhje me draftin, por në fakt nuk na u kërkua mendim nga administrata dhe na erdhi vetëm drafti, që mesa dëgjova ishin riparë, për shkak të komenteve të bëra edhe nga trupa juaj, po në fakt nuk kishte asnjë relacion bashkëngjitur që të kujt ishin komentet, ndryshimet ku konsistonin, pse

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

duhet pranuar apo jo këto ndryshime dhe me keqardhje unë shoh sot që akoma nuk kemi një dakordësi të trupës tuaj dhe administratës së KQZ-së lidhur me draftin. Pra, pavarësisht asaj tërheqje të aktit nga ana e administratës sërish shoh që nuk janë reflektuar propozimet apo ndryshimet, kështu që në këto kushte nuk kishim si jepnim mendimin për sa kohë nuk na u kërkua sepse thatë që ju i kishit propozuar administratës së KQZ-së që të bënte një konsultim me partitë politike lidhur me propozimet që ishin bërë në atë seancë...

Znj. I. Nano: Ndjesë, pa ju ndërprerë, për draftin e parë që ju është dërguar zyrtarisht në datën 4 ose 5 dhjetor, më herët është dërguar për njohje dhe mendim. Nga ana e subjektit që ju përfaqësoni kanë ardhur mendime me shkrim ose jo?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Për draftin e parë nuk kanë ardhur, jemi duke folur për draftin e dytë që jeni duke shqyrtuar dhe drafti i dytë ka ndryshime që nuk janë dhe aq jothelbësore, por për mendimin tim në disa pika janë esenciale, për këtë nuk na ka ardhur për mendim dhe aq më tepër as për konsultim nuk jemi thirrur për të diskutuar lidhur me këtë draft. Pavarësisht se vihet re që aty ka disa terma dhe terminologji të përdorura që për mendimin tim dalin jashtë kufijve të Kodit Zgjedhor, por që jemi duke folur për disa raste që ka kapërcim të termave se shikoj për shembull përdorimin e fjalëve anëtarë vëzhgues, por nuk do ndalemi në nene konkrete, jemi duke folur për pjesën në parim. Gjithsesi parimisht për të mos vonuar procesin se e dimë që jemi në afate maksimale që ligji na lejon, në parim jemi dakord për ta diskutuar dhe këtë draft të ri ka ardhur dhe pastaj për të dhënë opinionet kur të arrijmë nen për nen. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Xhina! Zoti Kaso dëshironi ju në parim për projektaktin?

Z. I. Kaso, përfaqësues i PD: Faleminderit e nderuar! Sigurisht. Atëherë jemi njohur edhe me draftin e parë dhe me draftin e dytë që është dërguar. Jemi këtu sot për të dhënë qëndrimin dhe komentet tona lidhur me procesin dhe lidhur me këtë hap përmbyllës shumë të rëndësishëm të këtij procesi, pasi sigurisht momenti i administrimit të vullnetit, i numërimit dhe i tabulimit të tij është pjesa më e rëndësishme e të gjithë procesit të votimit të shqiptarve me banim jashtë vendit sepse është ky moment që transformon vullnetin në votë dhe votën në rezultat zgjedhor. Kështu që është ajo qershia mbi tortë, është pjesa më e rëndësishme përmbyllëse, nuk kemi vlerësuar të dërgojmë komente paraprakisht, pasi pavarësisht se jemi pro në parim për rregullimin e këtij aspekti shumë të rëndësishëm, gjejmë te akti probleme konceptuale për mënyrën si është ndërtuar dhe mënyrën si është konceptuar në përgjithësi gjithë procesi nga Komisioneri dhe besoj këtu është vendi që Komisioni Rregullator të marrë gjithë përgjegjësitë e veta dhe të ndajë disa momente thelbësore, në radhë të parë për mënyrën se si e përfytyron ose mënyrën se si e sheh Rregullatori këtë proces kaq të rëndësishëm. Pra e sheh procesin e administrimit të vullnetit të shqiptarve jashtë vendit, të numërimit dhe të tabulimit të tij si pjesë integrale e Kodit Zgjedhor, që i nënshtrohet në kuadër të parashikimit të Kushtetues të barazisë të votës, të njëjtave rregullave, garancive, procedurave që ka Kodi Zgjedhor për votimin nga brenda apo e sheh si një proces tërësisht të shkëputur, për të cilin duhet të bëjë rregulla të reja dhe ky është problemi më i madh konceptual që ky akt nuk e zgjidh dhe Rregullatori në momentin që e miraton këtë akt duhet ta ndajë mendjen: ky proces është i njëjtë me atë që bëhet për vullnetin e shqiptarve që votojnë brenda vendit

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

dhe i nënshtrohet të njëjtës procedurë për sa të jetë e mundur, të njëjtave rregulla, të njëjtave garanci apo do shpikim, do krijojmë, jemi të detyruar, kështu erdhën rrethanat, të krijojmë një procedurë krejt të re si të administrojmë këtë vullnet, si ta tabulojmë dhe si ta përkthejmë në rezultat. Mënyrën si e shohim ne si Parti Demokratike parashikimet ligjore që Kodi Zgjedhor i ka bërë pjesë të vet me ndryshimet e fundit të korrikut të këtij viti, ne nuk besojmë që në asnjë gjurmë të asnjë neni të ndryshimeve i jepet leje kreative ose një lloj license kreative Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të shpikë një proces të ri, në një kohë që ka rregulla Kodi Zgjedhor për sa i përket edhe procesit të administrimit të votave dhe procesit të tabulimit të tij dhe procesit të përkthimit në rezultat zgjedhor. Unë besoj që nuk mundet që qoftë Komisioneri, qoftë Rregullatori, qoftë ju që përcaktoni këtë lloj procedure jeni të autorizuar nga Kodi Zgjedhor për të shpikur një procedurë krejt të re që në disa raste, siç e mendoni ju, flas KQZ-ja si e tërë, se ju s'jeni shprehur akoma, përngjason në momente të caktuara me atë të administrimit të vullnetit të shqiptarve që votojnë brenda vendit. Në disa raste abstragon krejtësisht nga ky koncept dhe e lë krejt në diskrecionin e Komisionerit, ashtu siç është dhe një nga parimet kryesore me të cilin hapet akti, këtë moment kaq të rëndësishëm. Tani, unë besoj që këto probleme konceptuale duhet të marrin drejtim në radhë të parë, që në momentin e konceptimit të aktit dhe në qoftë se biem dakord të gjithë ne besojmë që ka qenë vullnet i legjislatorit që ky proces administrimi, numërimi, vlerësimi dhe tabulimi duhet të jetë i njëjtë me atë që ndodh për votat që hidhen brenda vendit, besoj që akti edhe për ju bëhet shumë i thjeshtë sepse referenca në këtë rast në ligj do të ishte e qartë dhe e pastër që i nënshtrohet të njëjtës procedurë, të cilin ligji e ka detajuar deri në hallkën më të vogël. Kemi një Kod Zgjedhor nga më të komplikuarit jo vetëm në raport me vendet e tjera fqinj por besoj nga më të komplikuarit në Evropë, për shkak të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

nevojës, të detajimit të çdo hapi, do hallkë procedurale që na çon nga procesi i votimit, deri në procesin e përkthimit të këtij vullneti në rezultat zgjedhor. Në qoftë se ju prapë do ta shihni të arsyeshme që këtë proces ta shihni krejtësisht të ndarë nga ky lloj procesi për sa i përket votave brenda vendit, do t'ju duhej që me këtë akt të rishkruanit një Kod të ri Zgjedhor, për sa i përket votimit nga jashtë, që duhet të përfshijë, siç e tha dhe zonja Vukaj, që u ndal në një moment, por që besoj momente të tilla ka shumë, që procesin e administrimit, në momentin që këto vota hynë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përgjegjësi të kujt ndodh kjo? Sepse KQZ-ja është term i gjerë dhe në qoftë se ju e keni detajuar këtë aktin e mëparshëm, thoni në KQZ, këtu po e shohim, në këtë mbledhje që edhe këtu përballë nuk ka një KQZ të vetme, një vullnet KQZ-ja. Pra, duhet me këtë akt ta ndanin përgjegjësi të kujt janë këto vota që hynë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rolin dhe përgjegjësi të çdo organi të administratës, duke përfshirë doganat, duke përfshirë policinë e shtetit, protokolle të cilat ata kanë në zbatim të ligjeve të tyre organikë ose të procedurave, standarde të miratuara dhe gjithçka tjetër që detajon Kodi Zgjedhor, çdo hap tjetër, në mënyrë analoge edhe për procesin e votimit nga jashtë, pra nuk duhet të kishit një akt me dhjetë nene, siç e keni por duhet të kishit një akt me 50, 60 nene. Tani unë jam dakord me sensibilitetin e z.Çaka që tha që duhet ta miratojmë nesër, duhet të ishte miratuara para një muaji ndoshta. Në kushtet e vonesës, më mirë të ulemi të bëjmë një gjë të saktë, të gjithë së bashku, se sa nga nxitimi për ta miratuar nesër që nuk ka, të paktën në dijeninë time ndonjë afat ligjor, ndonjë deadline ligjor që përfundon nesër, pse jo pasnesër, pse jo pas një jave, në momentin që jemi vonë, se sa rëndësia e aktit për të mbuluar çdo aspekt të këtij procesi shumë delikat dhe mbi të gjitha nevojën për të bërë transparencë, e cila do të përkthehej në besueshmëri, për të gjitha këto që jo vetëm janë përfshirë në dorën e parë dhe janë të intereurit e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

parë për procesin por mbi të gjitha për ata dhejtra, mijëra shqiptarë, të cilët më së fundmi presin të votojnë për herë të parë nga jashtë në këto zgjedhje. Kështu që unë besoj, duke rikonfirmuar edhe njëherë mbështetjen në parim për këtë akt, akti duhet riparë i gjithi nga pikëpamja konceptuale në radhë të parë, për të ndarë dilemën e madhe, ky është proces administrimi dhe përkthimi i vullnetit që ndodh brenda kornizës të madhe që përcakton Kodi Zgjedhor dhe do të kryhet në të njëjtën mënyrë analoge me atë që ndodh brenda vendit apo do të rishkruajmë një proces të detajuar, risi nga e para. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit z. Kaso! Nga shoqata “Diaspora për Shqipërinë e lirë”, po mundet të ulëshit thjesht një mikrofon, z. Florian Haçkaj. Z. Haçkaj!

Z. F. Haçkaj, përfaqësues i shoqatës “Diaspora për Shqipërinë e lirë”:
Përshëndetje të gjithëve! Jam i nderuar që jam këtu mes jush dhe për ta parë procesin më në fund se si realisht shkon ky diskutim. Për pjesën juridike, ne parimisht jemi dakord dhe t’i diskutojmë nen për nen dhe Klodiana Rado që është eksperte do t’i diskutojë më vonë. Më lejoni që në indinjatën që kam shprehur me email, të vazhdoj ta shpreh këtu sepse po shoh, ta them pse? Në datën 11 janar presupozohet që diaspora do të fillojë të regjistrohet dhe kjo është vështirësia më e madhe sepse ju duhet të kuptoni që njerëzit kanë ndërgjegje të lartë qytetare dhe nuk mund të pranojë të regjistrohen në një proces pa ditur sesi do të përmbillet ai, prandaj indinjata ime shkon tek të gjithë ju këtu dhe tek partitë politike dhe tek mënyra e të punuarit, që ne e kemi ngritur shpesh se pse nuk vinë komentet me shkrim dhe në gjykimin tonë dhe ju që jeni aty Komision Rregullator, jeni përfaqësues partie politike, pra në anën njerëzore komunikimi ndërpartiak, që është totalisht i munguar me këtë çfarë po shohim, për ne si “Diasporë për Shqipërinë e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

lirë”, që na ka treguar një kulturë pune, është jo i kënaqshëm. Tani si do ta bënim, ju thoni të gjejmë një datë tjetër zonja Vukaj, z. Çakaj përmend mbi 1.2 milion shqiptarë dhe janë pikërisht presioni i të gjithë këtyre për ta kaluar këtë proces. Nga ana njerëzore unë do të dëshiroja që minimumi nëse ju sot nuk bini dakord, që duket qartazi që s’do keni dakordësi, të keni po sot datën tjetër, qoftë kjo nesër apo mbas një jave siç tha z. Kaso, por ta keni dakordësinë tashmë dhe unë do të logjikoja duhet të uleni të diskutoni, nuk vjen kjo tryeza ku jeni ku diskutohen këto gjëra, kur është një diskutim publik, i hapur por përmbillet pa asnjë përmbyllje. Kjo ma lejoni edhe një herë, me gjithë respektin, ju lutem çojeni përpara këtë proces, përmbylleni një orë e më parë sepse do të ishte jo e drejtë dhe e papranueshme kundrejt gjithë asaj diaspore që kjo, e drejtë kushtetuese t’i mohohet për një kulturë pune jo të duhur. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit z.Haçkaj! Nga organizata KRIIK ka diçka në parim lidhur me projektvendimin, nëse mundeni, mund t’i drejtoheni mikrofonit.

Z. D. Taulla, përfaqësues i KRIIK: Faleminderit! Në parim KRIIK-u siç jeni në dijeni ka dërguar një sërë komentesh dhe rekomandimesh në lidhje me aktin që po diskutohet sot. Kemi qenë edhe pjesë e konsultimit online. Në përgjithësi ne gjejmë që akti ka përmbushur një sërë prej rekomandimeve tona. Mund të ketë gjëra të vogla, po tani unë do ta mbaj vetëm në parim diskutimin që mund të shihen, mund të përmirësohen. Në lidhje me aktin konkret nuk është se kemi pasur kohën dhe mundësinë që ta shohim saktësisht se çfarë, cilat nga rekomandimet tona tashmë janë përmbushur dhe cilat specifikisht ne mund të dërgojmë rekomandime sërish nëse do të jetë nevoja, por që e gjejmë aktin në përgjithësi shumë pozitiv dhe gjejmë që rekomandimet tona janë përmbushur. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Faleminderit z. Taulla! Atëherë mbyllim diskutimet në parim për projektvendimin dhe kalojmë në votimin në parim të tij. Kolegë kush është dakord në parim? Po patjetër diskutim në parim kush dëshiron?

Znj. A. Smorgraf, përfaqësuese e KKD: Pata lënë një takim në KQZ pikërisht në sallë ku jeni sot dhe meqenëse kemi qenë pjesë që nga fillimet e para, domethënë të diskutimeve të ligjeve dhe kemi dhënë kontributin tonë bashkë me grupin e “Diasporës për Shqipërinë e lirë” dhe përfaqësuesit e tjerë të diasporës, do të doja të shprehja në parim këtë akt nënligjor, e kemi diskutuar dhe ia kemi dhënë të gjitha mendimet tona, e kemi miratuar, flas në principe edhe me të gjitha detajet dhe komentet dhe kam përshtypjen që janë përfshirë pjesa më e madhe e komenteve apo sugjerimeve tona në disa nga ato ndoshta i takojnë cilësive të zbatimeve mekanike po them ose teknike në detaje siç është u shprehët dhe ju, ajo që unë dua t’i bashkohem edhe mesazhit që dha z. Haçkaj është që problemi kryesor është përgjegjësia ndaj diasporës. Duke qenë se ne kemi një datë që është e njoftuar dhe kemi filluar sensibilitetin të diaspora që në datën 11 janar hapet regjistrimi, pra është një proces shumë i vështirë, shumë i gjatë dhe kërkon, domethënë një angazhim të jashtëzakonshëm, do të ishte shumë e vështirë dhe zbeh dhe integritetin e gjithë procesit nëse aktet e tjera nënligjore nuk janë miratuar. Mua më vjen keq që sot, po na duken, domethënë sikur lexohet ky akt nënligjor nga gjithë pjesëmarrësit për herë të parë, ndërkohë që ky dokument ka kohë që është nisur me email në drejtim të të gjithë aktorëve. Pra pjesa tjetër që ne kemi insistuar dhe që unë e ritheksoj është që një nga shqetësimet që kemi parashtruar që në fillim kur është bërë dhe ndryshimi i Kodit ligjor është që vota e diasporës, meqenëse është hera e parë nuk do të dalë nga duhet të mblidhet në

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

qendrën e KQZ-së dhe nuk duhet të dalë nga institucioni ose po them nga bunkeri i KQZ-së. Në momentin që ju nxirrni nga kutia qendrore nëpër destinacione të tjera, aty i hapni rrugën dhe spekulimeve dhe abuzimeve, kjo është kryesorja dhe e para. E dyta bëhuni më të hapur dhe më të pranueshëm me këto akte që janë dhe le t'i japim mundësinë që vëzhguesit që të jenë aty dhe më të vëmendshëm, në momentin që ju rrisni numrin e personave, qoftë dhe me qasje politike, i bie që të përzgjedhë vetëm nga partitë kryesore dhe lini mënjanë pjesët e tjera. Diaspora është një, diaspora kërkon që kjo t'i mbrohet, me ndershmëri dhe të numërohet aty siç duhet. Nëse do të marrë kohë numërimi i votës me ditë të tëra, më mirë t'ia lëmë ditëve sesa t'ia lëmë një shpejtësie, ku mund të krijojë shqetësime dhe abuzime. Ky është domethënë mesazhi që unë do të doja, megjithë respektin që kam për ju të gjithë sepse nuk është e lehtë që të mblidheni, në ditët e fundit, në prag të festave, ku secili ndoshta do të kishte dëshirë të qëndronte pranë familjeve, por ju lutem do ishte dhurata më e bukur që do t'i jepnit diasporës nëse ju i mbaroni këto aktet nënligjore, me referencat apo sugjerimet tuaja për përmirësime në rregulloret apo procedurat teknike dhe të mbarohet kjo përpara 31 dhjetorit, në mënyrë që dhe ne të themi që gjithë bashkëpunimi ynë nuk ka shkuar kot. Ju faleminderit dhe ju uroj një fund viti dhe mbarësi dhe për 2025, për të gjithë ju!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Smorgraf! Po zonja Josifi!

Znj. J. Josifi: Ju lutem për transparencë të transparencës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në fakt dhe të Komisionerit mbi konsultimin publik që ne i bëjmë projektakteve përpara se ato t'i propozohen zyrtarisht Komisionit Rregullator. Marr shkas këtu nga komenti i përfaqësueses të Partisë Socialiste, në fakt projektvendimi që keni sot përpara jush, në mbledhjen e tij të dytë po e quaj, është

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

e para në fakt po dua të sqaroj afatet, pikërisht sepse ky ishte një projektvendim shumë i rëndësishëm sepse përmbledh në vetvete një hallkë thelbësore të procesit, atë sesi votat, si numërohet, se si do të vlerësohet, se si do të shkojë historia e rezultatit. Ne në fakt kemi sjellë për konsultim publik të gjithëve, Komisionit Rregullator, përfaqësuesve të partive politike, përfaqësuesve të organizatave të diasporës, organizatave të shoqërisë civile vendase, në datën 12 nëntor. Nga data 12 nëntor Komisioneri ka vënë në lëvizje, pra Komisioni Rregullator ka përcjellë zyrtarisht pas konsultimeve këtë projektvendim me datën 4 dhjetor, që do të thotë dy-tre javë kohë...

Znj. I. Nano: E kam theksuar unë dhe më herët, nga partitë politike..

Znj. J. Josifi: ..vetëm diçka doja të sqaroja

Znj. I. Nano: ...vetëm Partia “Shqipëria bëhet” ka sjellë komente me shkrim. Tani kjo ishte thirrje për të gjithë partitë politike të pranishme dhe jo mund të japin mendime me shkrim...

Znj. J. Josifi: Nuk mund të themi projektakti nuk është dërguar për mendim e nuk janë kërkuar mendime. Jo një moment të lutem ta mbaroj, se me rregulloren e Komisionit Rregullator të mbledhjeve të tij, nuk i ndërpritet fjala atij që jep përgjigje dhe komente. Tre javë është konsultuar...

Znj. I. Nano: Zonja Josifi mund të vini këtu ta drejtoni mbledhjen!

Znj. J. Josifi: Ndjesë!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*


Znj. I. Nano: Mund të vini këtu ta drejtoni mbledhjen.

Znj. J. Josifi: Po më duhet ta thojja, nuk po e drejtoj, po jap përgjigje ju lutem, ma dhatë fjalën...

Znj. I. Nano: Mund të vish këtu, hajde të drejtosh mbledhjen! Tani unë këtë e bëra si Kryetare Komisioni të Rregullator, si një nga anëtarët e Komisionit Rregullator iu drejtova partive politike, nuk jemi duke thënë, e the mirë, e the keq, këtu gabove, këtu kishe të drejtë, kjo është një thirrje publike, për të gjithë, për përfaqësuesit e partive politike, kur ju vinë akte për konsultim jepni mendime me shkrim, plus keni avantazhin jemi dhe këtu të pranishëm, të bëni sugjerime edhe këtu. Znj. Xhina, unë besoj, e dëgjova mirë dhe z. Kaso dhe znj. Xhina nuk e kemi sjellë tha për projektaktin e parë, e tha shqip. I dyti ka ardhur para dy ditësh, jo për konsultim, ky që po shqyrtojmë sot, me ato ndryshime, tani ne nuk mund të heqim përgjegjësitë tona nga vetja, të pestë ne së pari njëherë, për miratimin e aktit dhe t'i adresojmë te çdokush tjetër, secili ka përgjegjësinë e vet. Me përgjegjshmëri z. Haçkaj është këtu, znj. Smorgraf është online me ne, dy përfaqësues të partive më të mëdha politike janë me ne, ju jeni këtu, organizata KRIIK është këtu, kështu që unë mendoj diskutimet në parim t'i mbyllim, të kalojmë në votimin në parim të projektvendimit dhe më tej nen për nen. Atëherë kolegë kalojmë në votimin në parim të projektvendimit, kush është dakord? Po z. Çakaj, po.

Z. M. Çakaj: Atëherë, nisur nga projektakti dakord jemi në parim, por duhet të ndryshojë titulli i projektaktit...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Kur fillojmë të diskutojmë nen për nen, e fillojmë dhe me titullin, pra jemi dakord në parim, me këtë?

Z. M. Çakaj: Atëherë unë mendoj që duhet që në këtë moment...

Znj. I. Nano: Shihni procedurat që kemi ndjekur herët e tjera, kemi ndryshuar titullin, mbasi kemi miratuar në parim aktin, pra akti në parim është që rregullon një proces të numërimit, të tabulimit, mund të shtoni dhe ju administrimin, nesër, pasnesër. Pra një projektakt që na ka ardhur për diskutim, për shqyrtim, e votojmë në parim e pastaj shkojmë nen për nen, ku përfshihen dhe ndryshimet e mundshme në titull.

Z. M. Çakaj: Po pra po nuk është, atëherë projektakti ka titullin dhe miratimi në parim bëhet ...

Znj. I. Nano: Njëlloj kemi vepruar dhe në herët e tjera.

Z. M. Çakaj: Jo pra se nuk po hyjmë te nenet. Dakord kur të jetë te nenet.

Znj. I. Nano: Njëlloj kemi vepruar dhe më herët dhe kur kemi filluar nen për nen e kemi nisur dhe me titullin, edhe në mbledhjen e kaluar. Shikoni çfarë bëmë në mbledhjen e kaluar për miratimin e zonave për caktimin e zonave e administrimit zgjedhor, e mbaruam në parim, e votuam, kaluam nen për nen, kaluam në ndryshime në titull, pra titulli është pjesë e përmbajtjes, e asaj ndryshojmë, rregullojmë, shtojmë, heqim në fjalë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Mund të bëj një sugjerim?

Znj. I. Nano: Po.

Znj. H. Vukaj: Është e vërtetë ajo që thoni ju, ne ashtu e kemi bërë sepse aktet përgjithësisht që kanë pasur të gjithë përmbajtjen e duhur dhe kishte gjëra të vogla për të rregulluar apo propozime të cilat, me sa duket janë votuar ose s'janë votuar. Këtu, unë mendoj që të bëjmë një përjashtim për shkak se akti është sensitiv dhe të votojmë në parim që në titull, pra titullin ta votojmë në parim sepse titulli duhet të jetë mot a mot njësoj si...

Znj. I. Nano: Që të ndryshojmë titullin duhet të nisi propozim ndryshimi i titullit, është ndryshim në përmbajtje të aktit, më kupto dhe njëherë znj. Vukaj, ndaj dua ta respektoj procedurën deri në fund. Propozim për ndryshim apo shtesë në përmbajtjen e aktit përfshi dhe titullin vjen në një moment më vonë.

Z. M. Çakaj: Më fal!

Znj. I. Nano: Po z. Çakaj!

Z. M. Çakaj: Atëherë meqë po flasim për rregulloren tonë, si rregull do të duhej, referuar nenit 26 të rregullores tonë, të miratuar nga ne të pestë do të duhej që fillimisht të ishte propozuar të paraqitej relacioni apo jo? Pastaj të kalonim në votimin në parim, diskutimet e të tjera me radhë, kështu që...

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Keni shumë të drejtë, është një kapërcim i imi, duke qenë se ju nisët çështje jashtë rendit të ditës, po u futët tek projekti konkret, çfarë është administrata, çfarë është vendi, ka bërë pyetje, përgjigje. Relacion zonja Josifi shkurtimisht.

Znj. J. Josifi: Faleminderit! Projektvendimi që është sot përpara jush për shqyrtim dhe në vlerësimin tuaj mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, dokumentacionin përkatës, ndjesë, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë vendit, vjen si propozim në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh” dhe Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, ku përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së, ose nga anëtarët e tij, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit. Në nenin 25/1, pika 1, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet që KQZ-ja nuk mund të pranojë dhe përfshijë në numërim asnjë fletë të mbërritur pas orarit të përcaktuar në këtë Kod, për mbylljen e votimit në qendrat e votimit, me përjashtim të zarfeve me fletë votimi, të cilët kanë vulën e hyrjes ose çdo shënim tjetër për këtë gjë, në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në orën e mbylljes së votimit brenda vendit sipas këtij Kodi. Në nenin 25/1, gjithashtu, pika 4, të Kodit Zgjedhor, që unë nuk po ripërsëris, u citua shumë herë deri më tani, ndërkohë Komisioni Rregullator me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përcakton me afatin ligjor dokumentacionin, mënyrën e plotësimit të tij si dhe çdo aspekt tjetër, për administrimin, vëzhgimin e procesit të numërimit, numërimin, vlerësimin e votës dhe tabelimin e rezultatit zgjedhor. Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencën e Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar atë. Ky

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

projektvendim konkretisht është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të Kodit Zgjedhor, me qëllim përcaktimin e rregullave dhe dokumentacionit në lidhje me proceset e cituara më lart, për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025, në këtë rast. Projektakti rendit parimet të përgjithshme, të cilat janë shtyllat ku do të mbështetet procesi i vlerësimit dhe numërimit të votave. Në kreun e parë parashikohen parimet si vijon, që do t'i shohim në këtë projektvendim, nuk po ndalem, është, ky proces do të duhet të respektojë parimet e ligjshmërisë, paanshmërisë, transparencës dhe sigurisë për votën, si dhe gjithashtu jepet parimi i diskrecionit që e kemi mbartuar tashmë në disa nga aktet normative që lidhen me procesin e votimit nga jashtë vendit. Në kreun II ndërkohë parashikohen rregulla të përgjithshme, për atë që përcakton në ligj, sa i takon këtij procesi. Në kreun III jepen rregullat e posaçme që lidhen me përgatitjen për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë vendit, gjithashtu personeli përgjegjës për numërimin dhe vlerësimin e këtyre votave si dhe aspekte që lidhen me administrimin dhe dërgimin e dokumentacionit zgjedhor të votimit nga jashtë në ambientet e vendit VNVJ-së, sikundër do t'i referohemi në këtë projektvendim. Gjithashtu në zbatim të nenit 93, pika 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor, parashikohet vendodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe vendeve të numërimit të votave, kemi marrë atë që shpjeguam deri tani, analogjinë për të përcaktuar rregullat gjithashtu që do t'i shërbejnë vendimit për caktimin e vendit të numërimit të votave nga jashtë. Gjithashtu cilët do të jenë personat që do të duhet të lejohen, të jenë të pranishëm në këtë VNVJ, të cilët janë listuar, renditur në përkatëse të këtij projektvendimi. Numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë do të kryhet nga një trupë që në këtë projektvendim konsiderohet ajo e Komisionit të numërimit dhe vlerësimit të votave nga jashtë, referuar më tej si GNVJ si dhe grupet e numërimit të votave nga jashtë, referuar në këtë projektvendim si GNVJ. Komisioni i cituar më lart në propozimin

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

tonë përbëhet nga propozimin e Komisionerit, përbëhet nga tre anëtarë, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në një afat jo më vonë se 20 ditë përpara datës së zgjedhjeve, kushtet dhe kriteret që ata do të duhet të plotësojnë janë sikurse janë ato për emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve në procesin brenda vendit e po ashtu shkarkimi i këtyre anëtarëve gjithashtu. Ndërkohë, unë po i referohem relacionit të projektvendimit të propozuar me shkrim, po ndërkohë në propozimet siç ju thamë të para dy ditëve të Komisionerit, të përcjellë si sugjerim parashikohen që në këtë Komision të ketë edhe dy anëtarë vëzhgues, përkatësisht nga partia më e madhe e pozitës dhe partia më e madhe e opozitës. GNVJ-të përbëhen sipas këtij propozimi nga dy anëtarë, të caktuar nga KQZ-ja, afati për caktimin e tyre, jo më vonë se dhjetë ditë përpara datës së zgjedhjeve, kushtet dhe kriteret që ata do të duhet të plotësojnë, për analogji janë të njëjta me ato që plotësojnë anëtarët e grupeve të numërimit për procesin brenda vendit, përjashtuar kushtit të vendbanimit në zonën zgjedhore përkatëse se nuk do të kishte kuptim në këtë rast, po ashtu shkarkimi është për të njëjtat shkaqe që vlen edhe shkarkimi i anëtarëve të grupeve të numërimit nga brenda vendit, është përcaktuar një limit për numrin e votave nga jashtë që do të duhet të numërojë çdo grup numërimi, për analogji është përdorur logjika e llogaritjes si për procesin brenda vendit. Partia më e madhe e shumicës parlamentare dhe partia më e madhe e opozitës parlamentare do të kenë të drejtë gjithashtu, sipas këtij propozimi të caktojnë nga një vëzhgues pranë tavolinës së çdo grupi numërimi. Ata do të kenë të drejtë të monitorojnë dhe të vëzhgojnë procesin e numërimit dhe vlerësimit të votave, por edhe të shënojnë komentet e tyre në tabelën e rezultatit. Anëtarët kanë një, ka parashikime se anëtarët e grupeve të numërimit të caktuar në turnin e parë kanë një moment në kohë, në të cilin duhet të jenë të pranishëm në VNVJ, e po ashtu përfaqësuesit e partive parlamentare, si një element garancie në KQZ kanë të drejtë të përjashtojnë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

nga qenia anëtar i Komisionit por edhe i GNVJ-ve çdo person të caktuar në atë detyrë, në rast se ata kanë dyshime për profesionalizmin dhe paaftësinë e këtij personi, këtë të drejtë ata do të duhet ta ushtrojnë vetëm njëherë sipas propozimit të Komisionerit. Në lidhje me dërgimin e dokumentacionit zgjedhor të votimit nga jashtë vendit në ambientet e VNVJ-së, në projektvendim përcaktohet se dokumentacioni i administruar sipas përcaktimeve të vendimit numër 13 të 2024, të Komisionit Rregullator, do të dërgohen dhe transportohen në ambientet e VNVJ-së sipas afateve të përmendura në këtë projektvendim. Sa i takon dokumentacionit që i shërben administrimit të materialeve zgjedhore, për dorëzimin në VNVJ të kutive të votimit nga jashtë, kutive të posaçme, kutive rezervë dhe kutive të posaçme rezervë, që për lehtësi po i referohem si kutitë, pra të katërta llojet e kutive do të mbahet një procesverbal dorëzimi midis, të paktën një anëtar i GNVJ-së dhe personelit të KQZ-së që është i ngarkuar me dorëzimin e këtyre kutive, kopje të tij, padiskutim i vihet në dispozicion si palëve nënshkruese ashtu dhe vëzhguesve të partive parlamentare, përpara dorëzimit të kutive do të duhet të bëhet indeksimi i tyre me numra natyrorë të njëpashnjëshëm duke filluar nga 1 veçmas për secilën nga katër kategoritë e indeksimi fillon në radhë sipas qarqeve, sikurse janë numërtuar qendrat e votimit brenda vendit. Transportimi i kutive nga ambienti ku ato ruhen dhe administrohen sipas përcaktimeve të vendimit tuaj numër 13 të datës 12 nëntor 2024, për në vendin e numërimit të votave nga jashtë do të bëhet i shoqëruar nga policia e shtetit, për analogji me procesin brenda vendit. Kreu IV i këtij projektvendimi përcakton në mënyrë të detajuar rregullat pastaj që lidhen me numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë vendit dhe procedurën që do të ndjekë secili nga grupet e numërimit për secilën nga kutitë, përkatësisht atë të votimit nga jashtë, kutinë e posaçme, kutinë rezervë dhe kutinë e posaçme rezervë. Në lidhje me procedurën ose me momentin se kur fillon

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë vendit, në projektvendim parashikohet se kur KQZ, në bazë të njoftimeve të marrë nga KZAZ-ja apo KZAZ-të e zonës zgjedhore përkatëse konstaton se ka filluar numërimi i kutisë së parë të votimit për atë zonë zgjedhore, do të fillojë menjëherë numërimi dhe vlerësimin e votave nga jashtë për këtë zonë, kjo detyrë e këtij njoftimi i është lënë në këtë propozim, në këtë projektvendim të propozuar sekretarit të KZAZ-së dhe ai bëhet përmes mënyrave të komunikimit të detajuara në këtë projektvendim. Në kreun V të këtij projektvendimi parashikohen rregulla në lidhje me llojet e vlerësimit të votave dhe tabulimit të rezultatit zgjedhor, sa i përket vlerësimit të votave, në zbatim të nenit 117 të Kodit Zgjedhor janë përcaktuar llojet e votave si dhe kriteret për vlerësimin e tyre, në këtë kuptim vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij. Krahas sa parashikohet tjetër në këtë akt, votat të pavlefshme jepen gjithashtu llojet e votave të pavlefshme, janë fletët e votimit kur fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë apo formë në fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja, në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që e bëjnë të pamundur vlerësimin e votës. Në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore, është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit, nuk është votuar dhe nuk po vijoj. Janë të njëjtat raste të vlerfshmërisë apo pavlefshmërisë së votës, të përcaktuara në Kod gjithashtu edhe për votën brenda vendit, në lidhje me tabulimin e rezultatit të votave nga jashtë, në këtë projektakt parashikohet se të dhënat mbi numrin e votave të subjekteve zgjedhore dhe të kandidatëve të pasqyruara në procesverbalin përkatës të grupit të votimit, për çdo zonë zgjedhore, përfshihen nga Komisioni i Numërimit dhe Vlerësimit të Votave nga Jashtë, në tabelën e rezultatit të votimit nga jashtë të zonës zgjedhore përkatëse. Kjo tabelë do të duhet të nënshkruhet nga

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

të gjithë anëtarët e GNVJ-së, përfshirë dhe ata vëzhgues dhe më pas i dorëzohet KQZ-së. KQZ-ja do të përfshijë të dhënat e tabelës së rezultateve të votimit nga jashtë në tabelën të zonës zgjedhore, në tabelën përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore përkatëse, pra integrimin e votave brenda dhe jashtë vendit. Në kreun VI të këtij projektvendimi përcaktohen rregullat e monitorimit, edhe vëzhgimit të proceseve, të të gjitha proceseve të rregulluara nga ky akt, ku përcaktohet e drejta e çdo subjekti për të caktuar një vëzhgues për çdo tavolinë numërimi. Këtë të drejtë e ka edhe çdo organizatë vendase apo e huaj, e cila ka marrë gjithashtu akreditim për vëzhgimin e zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Vëzhguesit kanë të drejtë të marrin kopjet e tabelës së rezultatit të votimit nga jashtë të zonës zgjedhore. Për sa më lart në këtë relacion Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve brenda kompetencave të veta, edhe në respektim të detyrimeve dhe afateve ligjore të caktuara në Kodin Zgjedhor propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë vendit”. Ndërkohë në relacionin shpjegues të projektaktit janë sqaruar, është sqaruar dhe kronologjia e konsultimit të këtij projektvendimi, sikundër e cekëm në diskutimin në parim. Ndryshimet përtej projektvendimit të propozuar zyrtarisht qëndronin në adresimin e çështjes së ngritur nga Kryetarja e Komisionit Rregullator në mbledhjen më të fundit lidhur me këtë projektvendim, si edhe me sugjerimin e anëtarit të Komisionit Rregullator për të përfshirë anëtarët vëzhgues në komisionin e numërimit dhe vlerësimin të votave nga jashtë. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Josifi! Atëherë hallkat e tjera proceduriale i kapërcyem, me pyetje, me diskutime në parim. Se në fakt në zbatim të rregullores sonë çështjet jashtë rendit të ditës duhet të paraqiten në fillim dhe të diskutohen në

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

fund, megjithatë u përzier pak sot, të gjitha në të mirë të procesit padyshim, nuk shkaktuam ndonjë dëm të madh! Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit, kolegë kush është dakord?

Z. M. Çakaj: A ta bëj propozimin tani?

Znj. I. Nano: E lamë që jo, sepse titulli, ndryshimi i titullit është ndryshim në përmbajtjen e projektit, kështu që kur të shqyrtohet

Z. M. Çakaj: Dakord, jemi dakord në parim.

Znj. I. Nano: Kush është dakord dhe njëherë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (z. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në shqyrtimin dhe diskutimin nen për nen dhe duke nisur nga titulli. Projektvendim “Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë”. Preambula që përcakton dhe mban bazën ligjore janë nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, kompetenca e Rregullatorit, nenit 25/1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, propozimi është i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Zonja Vukaj!

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Atëherë, sapo lexuat në preambul që bazë ligjore për këtë propozim, bazë ligjore materiale është neni 25/1, i ligjit. Po të shohësh nenin 25/1, në pikën 4, paragrafi i fundit thuhet se “Rregullatori me propozimin e Komisionerit përcakton me akt nënligjor, dokumentacionin, mënyrën e plotësimit të tij dhe çdo aspekt tjetër për administrimin, vëzhgimin e procesit të numërimit, numërimin, vlerësimin e votës dhe tabelimin e rezultatit zgjedhor sipas nenit”. Të nderuar ne jemi pikërisht në këtë fazë, pra po shqyrtojmë këtë akt, i cili nuk e pasqyron këtë citat dhe këtë përcaktim të ligjvënësit, ndaj unë me shumë të drejtë dua që këtë ta transpozoj ashtu siç përcaktohet në këtë nen, që në titullin e këtij projektakti. Propozimi im është, titulli të jetë, projektvendim: “Për rregullat, për administrimin, vëzhgimin e procesit të numërimit, numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë vendit”.

Znj. I. Nano: Kolegë keni diçka për propozimin e zonjës Vukaj? Kalojmë në votimin e këtij propozimi, kush është dakord?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë te nen për nen, kreu I, parimet. Siç kemi vepruar dhe herët e tjera, meqenëse i kemi të ndarë në krerë, unë lexoj gjithë kreun dhe pastaj nëse ka ndërhyrje. Kreu I, parimet: “1. Procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave të votuesve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë respekton parimet e

***Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

ligjshmërisë, paanshmërisë, transparencës dhe sigurisë për votën. 2. Parimi i diskrecionit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtën të veprojë me diskrecion brenda limiteve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e votës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Diskrecioni ushtrohet në mënyrë që të përmirësohen proceset dhe të adresohen situata të paparashikuara për të garantuar realizimin e votës.” Për këtë kre kemi diçka? Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Ashtu sikundër kemi miratuar në të gjithë aktet e tjera, që kanë kaluar përmes votës sonë dhe shqyrtimit që ne i kemi bërë me shumë delikatesë duke iu përmbajtur Kushtetutës, Kodit të Procedurës Administrative dhe me qëllimin e vetëm, përforcimin dhe rritjen e standardit të tyre dhe vlerës së tyre, ashtu dhe në këtë akt unë do të propozoj përforcimin e kësaj fashe, pra të kreut I, me parimet që i rrinë për shtat dhe janë parime të cilat i kemi mbartur dhe në të gjithë aktet e tjera. Unë personalisht nuk e gjej që ky proces mund të mjaftohet vetëm me dy parime, ose me pak parime të listuara. Po të listuara parimet, por mendoj që këto parime duhet patjetër të përcillen si parime të mevetme, të shprehura aty për hir të rëndësisë që ka procesi dhe fazave në të cilat ai kalon, ndaj në propozimin tim unë, pikën 1 do ta zëvendësoja, tipikisht me parimin e ligjshmërisë, marrë nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative, meqenëse është Kodi, ose kuadri tjetër ku ne referohemi për forcimin e akteve tona. 1. Parimi i ligjshmërisë. Procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave të votuesve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe brenda kufijve të kompetencave të KQZ-së dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. Të drejtat apo interesat e ligjshme, të zgjedhësit nga jashtë vendit nuk mund të çenohen nga veprimi administrativ, përveçse kur parashikohet

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor. Baza ligjore është neni 4, i Kodit të Procedurave Administrative. 2. Parimi i dytë që duhet të shoqërojë këtë akt, mendoj dhe propozoj: Parimi i transparencës dhe informimit, apo do t'i kalojmë për votim parimet?

Znj. I. Nano: Jo, e lexoni komplet propozimin për ndryshim në kreun “Parimet” dhe pastaj e votojmë.

Znj. H. Vukaj: Parimi i transparencës dhe informimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zhvillon procesin e numërimit dhe vlerësimit të votave nga jashtë vendit, mos ndoshta duhet secili sepse mos mendoni se ndikon dhe s’kemi pse prishim rendin e secilit?

Znj. I. Nano: Si e keni menduar ju propozimin mund ta lexoni, sipas radhës që e keni menduar. Pra ju po zëvendësoni këto dy parime me një sërë parimesh të tjera të elaboruara...

Znj. H. Vukaj: Të elaboruara po, atëherë dhe njëherë, parimi i transparencës dhe informimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zhvillon procesin e numërimit dhe vlerësimit të votave nga jashtë vendit në mënyrë transparente duke dhënë informacion publikut sa herë që kërkohet nga çdo person. 3. Parimi i mbrojtjes së të dhënave. KQZ ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm, të të dhënave të zgjedhësve nga jashtë vendit, në rastin e ushtrimit të së drejtës së votës dhe numërimit e saj, të marrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen si dhe konfidencialitetin e tyre. 4. Parimi i drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit. KQZ gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave nga jashtë vendit, duhet të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

kryejë proceset në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, pavarësisht vullnetit të shprehur të zgjedhësit nga jashtë. Gjithashtu KQZ duhet t'i japë rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe dokumenteve që lidhen me procedurën e numërimit dhe vlerësimit të votës së zgjedhësve nga jashtë. 5. Parimi i sigurisë së votës dhe përgjegjësisë. KQZ dhe administrata e saj respektojnë të gjitha rregullat normuese që kanë të bëjnë me sigurinë e votës nga jashtë dhe kryejnë të gjitha procedurat që lidhen me proceset e sigurisë së votës, numërimit, vlerësimit dhe përfshirjes së tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve, me përgjegjësi në përputhje me legjislacionin përkatës. 6. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit. KQZ ushtron procesin e administrimit, numërimit, vlerësimit dhe tabelimit të votës nga jashtë, në përputhje me parimin e barazisë. Vota e zgjedhësve nga jashtë procesohet dhe trajtohet në mënyrë të barabartë me votën e zgjedhësve nga brenda vendit. KQZ shmang çdo diskrimin sipas përcaktimeve të nenit 17 të Kodit të Procedurës Administrative. Më pas kalojmë tek parimi i ushtrimit të ligjshmërisë, të diskrecionit, që zëvendëson pikën dy aktuale dhe kjo është pikë 7..

Znj. I. Nano: Në fakt unë do të kisha sugjeruar të na i kishit dhënë me shkrim se ju i keni përgatitur me shkrim dhe ne vetëm po dëgjojmë dhe do të kishim një vëmendje të shtuar nëse do ta kishim të shkruar këtë propozim.

Znj. H. Vukaj: Në fakt për hir të mungesës së logjistikës dhe këtë ma printuan tani së fundmi, kështu që...

Znj. I. Nano: E shumëfishojmë po të jetë...

Znj. H. Vukaj: Po patjetër.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. I. Nano: Para se të kalojmë në votim se unë dua ta lexoj këtë, mendova se ishte dy paragrafë, po është më shumë.

Znj. H. Vukaj: Po patjetër, megjithëse kemi audio, kështu që. Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të ushtrojë diskrecion të ligjshëm brenda kuadrit të parimeve të përgjithshme të parashikuara të Kodit Zgjedhor, si dhe pa kaluar kufijtë e përcaktuar në Kushtetutë dhe Kod Zgjedhor, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e votës të shtetasve shqiptarë jashtë vendit. 8. Parimi i kontrollit. Veprimtaria e administrimit, numërimit dhe vlerësimit të votave i nënshtrohet kontrollit administrativ, gjyqësor dhe çdo kontrolli tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kaq ishin propozimet e mia për sa i përket kreut të parë “Parime”.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Pesë minuta pushim sa t’i keni, jepjani ju lutem administratës t’i shumëfishojë, t’i kemi para se të votojnë mbi këto.

Rifillon seanca

Ora 14:45

Znj. I. Nano: Rifillojmë atëherë mbledhjen e Komisionit Rregullator të ndërprerë para pak. Kërkuam të na viheshin në dispozicion propozimet që sapo zonja Vukaj bëri në mbledhje, duke qenë që ishin voluminoze, vetëm për kreun I, “Parimet” dhe personalisht kam nevojë që t’i lexoj me vëmendje sepse në bazë të parimeve, padyshim që ndërtohen dhe proceset e tjera, duke pasur parasysh parimet, më tej

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

janë rregullat e përgjithshme dhe proceset e tjera. Nuk e di, kolegët si mendojnë?
Po z. Çakaj!

Z. M. Çakaj: Po, atëherë. Sigurisht dakord që të merrni kohën, në vlerësimin, gjykimin por edhe bindjen tonë të brendshme, të timen, të koleges Vukaj, besoj dhe të kolegëve të tjerë të nderuar, unë besoj që procesi do të vijojë normalisht, proceset vijuese, pra procesi i thirrjes nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Te akti i kaluar kemi lënë një afat dhjetë ditë, pra procesi i vijimit të regjistrimit, për sa kohë PER-i do të jetë funksional do të vijojë normalisht dhe ky akt, nuk ndikon qoftë ky, qoftë akti deklarativ, nuk ndikon, nuk e pengon procesin e regjistrimit...

Znj. I. Nano: Procesin e regjistrimit doni të thoni?

Z. M. Çakaj: Kështu që hajde të ulemi, diskutojmë, e shkruajmë mirë këtë akt, pa cënuar dhe proceset e tjera, në mënyrë që t'i japim standardin e duhur gjithë shqiptarve me banim jashtë vendit, pra të marrin kohën e duhur, ta bëjmë tamam, sigurisht jo pafundësisht kjo koha, por dhe mos t'i lidhim t'i përziejmë proceset me njëra-tjetrën. Nga ana tjetër Komisioneri është i lirë të vijojë me procesin e regjistrimit të gjithë shqiptarve dhe sigurisht në momentin më të parë, që do të kemi dakordësuar, do të japim paketën e plotë ligjore. Kini parasysh që ky është një proces rishtar për ne, kështu që më mirë ta bëjmë pak më vonë, por ta bëjmë mirë se sa të gabojmë dhe t'i rikthehemi përsëri. Kaq kisha.

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Si propozuese jam dakord me çfarë kërkuat, të merrni kohën tuaj, vlerësoni parimet sepse ato janë jashtëzakonisht të rëndësishme sepse mbi bazën e tyre ndërtohet i gjithë procesi, kështu që merrni kohën tuaj e më pas vijojmë procedurën sipas dakordësisë që do të kemi ardhjen për proces.

Znj. I. Nano: Po z. Nuri.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Meqenëse jemi te parimet dhe Komisioni Rregullator do të shqyrtojë pikërisht këto elementë që sapo u propozuan dhe ne si subjekte politike, përfitojmë nga rasti të propozojmë dhe ne një parim, një shtesë të një parimi nga ato që u thanë, në mënyrë që t'i diskutoni dhe të keni mundësi, t'i shikoni të gjitha së bashku. Te pjesa, kreu i parimeve, Partia Demokratike kërkon që të përfshihet kjo dispozitë, procesi i numërimit dhe i vlerësimit të votave të votuesve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë i nënshtrohet të njëjtave rregullave, procedurave dhe garancive, procesi i votimit brenda vendit. Ky është parimi që ne si subjekt, si parti politike po themi, të interesuar kërkojmë që të përfshihet tek parimet. Përfitoj dhe nga rasti por edhe për një element tjetër që është jashtë kësaj teme, po themi ka lidhje me votën e diasporës. Në mbledhjet e shkuara unë pata kërkuar posaçërisht nga administrata e KQZ të na vihej në dispozicion lista e punonjësve që punojnë në Drejtorinë e Emigracionit dhe deri më tani kjo listë nuk na është vënë në dispozicion, përfitoj nga rasti që t'ia kërkoj edhe këtë gjë administratës së KQZ-së. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Z. Nuri faleminderit! Meqenëse ne menduam që të marrim kohë për ti parë parimet, ju lutem propozimin tuaj na e çoni me email, me shkrim që ta kemi, bashkë me propozimin e zonjës Vukaj. Zonja Josifi për këtë pyetjen e dytë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 30.12.2024*

Znj. J. Josifi: E gjithë lista, organigrama, struktura e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me emra nominalë, në të gjithë administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në secilën drejtori, në secilin pozicion është e publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, mund t'ju dërgojmë linkun, është aty, është e përditësuar. Në fund tek footer-i i transparencës është struktura, janë emrat e ngjitur pas çdo pozicioni për të gjithë drejtoritë, për procesin brenda vendit dhe atë jashtë vendit.

Znj. I. Nano: Mund t'ia dërgoni linkun përkatës z. Nuri. Atëherë kolegë në këtë moment caktojmë dot një ditë tjetër për t'u mbledhur apo do të njoftohemi me email me njëri-tjetrin dhe kuptohet edhe palët e interesuara për zhvillimin e mbledhjes? Çështje tjetër në rendin e ditës nuk kemi, çështje jashtë rendit të ditës u ezuarua në fillim të mbledhjes. Mbledhjen për sot e deklaroj të mbyllur!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

